



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 41 regjistër (JR)  
Datë 21.10.2024

Nr. 37 i vendimit  
Datë 08.05.2025

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Albana Shtylla</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Relator</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 08.05.2025, ora 14:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier De Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Arjela Vllaçaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 41/2024 (JR), datë 21.10.2024, që i përket:

**ANKUES:** Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 762, datë 15.05.2024, që i përket subjektit të rivlerësimit Afrim Shehu.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme të përfaqësuar nga prokurori pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, z. Klodjan Braho, i cili përfundimisht bazuar në nenet 61, pika 3 dhe 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 762, datë 15.05.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Afrim Shehu dhe shkarkimin e tij nga detyra, dëgjoi subjektin e rivlerësimit dhe avokaten Romina Zano, të cilët përfundimisht kërkuan lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë në prezencë të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Afrim Shehu, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), ushtronte detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, ai iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor<sup>1</sup>, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë<sup>2</sup>, deklaratën për kontrollin e figurës<sup>3</sup>, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional<sup>4</sup>.
3. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
  - (i) *Deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin.*
  - (ii) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*
  - (iii) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*
  - (iv) *Nuk ka kryer deklarim të rremë.*
  - (v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

<sup>1</sup>Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

<sup>2</sup>Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 29.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së me nr. {\*\*\*} prot., datë 29.01.2017.

<sup>3</sup>Referuar “Deklaratës për kontrollin e figurës”, dorëzimi është kryer më datë 26.01.2017.

<sup>4</sup>Dorëzuar pranë Prokurorisë së Përgjithshme më datë 26.01.2017, sipas referimit në “Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Afrim Shehu për periudhën 08.10.2013 - 08.10.2016” të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. {\*\*\*} prot., datë 30.10.2023.

4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dhe dërgoi një raport pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me anë të të cilit konstatoi përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës.
5. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit Afrim Shehu nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLP-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale), duke marrë vendimin nr. 762, datë 15.05.2024.

## **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

7. Komisioni, me vendimin nr. 762, datë 15.05.2024, vendosi: “Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Afrim Shehu, aktualisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë [...]”.
8. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “a” dhe 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit.

*8.1 Në lidhje me vlerësimin e pasurisë së subjektit, nga hetimi administrativ i kryer dhe shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në këtë kuadër rezulton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “vetting” ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Ai ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit Afrim Shehu, nuk vërtetohen shkaqe që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla për zbatimin e parimit të prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit. Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë e konstatuara dhe balancat negative të fondeve të rezultuara nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

*Për më tepër, Komisioni gjatë hetimit administrativ konstatoi se pasaktësitë e konstatuara dhe balancat negative të fondeve nuk kanë ndikuar në mënyrë thelbësore në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit. Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklarimet e pasakta të konstatuara si më sipër dhe problematikat e evidentuara në analizën financiare, nuk çmohen të mjaftueshme për cenimin e kriterit të pasurisë apo të vlerësohen si të tilla që të ndikojnë në vlerësimin tërësor në procesin e rivlerësimit të kryer për këtë subjekt. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe të mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e prokurorit dhe as besimin e publikut të drejtësia, pasi vlerësimi duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Afrim Shehu ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.*

**8.2** *Në lidhje me kontrollin e figurës, nga analizimi në tërësi i provave të grumbulluara gjatë hetimit administrativ, Komisioni arrin në përfundimin se për subjektin e rivlerësimit Afrim Shehu, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Afrim Shehu ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.*

**8.3** *Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, në analizë të raportit të hartuar nga KLP-ja, denoncimeve të depozituara nga publiku, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, gjë që mund të çonte në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.*

### **III. Shkaqet e ankimit**

9. Komisioneri Publik Florian Ballhysa, më datë 11.10.2024, ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 762, datë 15.05.2024, për subjektin e rivlerësimit Afrim Shehu në konsideratë edhe të “Rekomandimit për paraqitje ankimi” të tre vëzhguesve ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit me nr. {\*\*\*} prot., datë 30.09.2024, të cilin ia ka bashkëlidhur ankimit, duke e konsideruar si pjesë integrale të tij.
10. Komisioneri Publik pretendoi se vendimi i Komisionit objekt ankimi nuk është në pajtueshmëri të plotë me gjendjen e fakteve dhe provave të administruara në fashikull, për krijimin e bindjes se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, në kuptim të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

11. Për rrjedhojë, sipas Komisionerit Publik në zbatim edhe të rekomandimit të ONM-së, vendimi i Komisionit nr. 762, datë 15.05.2024, është i cenueshëm dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim pranë Kolegjit, nëpërmjet ankimit, i cili, bazuar në nenet Ç, D, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenet 4, pika 2 dhe 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, ushtrohet në tërësinë e tij. Komisioneri Publik kërkoi marrjen në shqyrtim nga Kolegji të shkaqeve të paraqitura në ankim dhe në përfundim të gjykimit, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa "b" e ligjit nr. 84/2016, Kolegji të vendosë:

◦ *Ndryshimin e vendimit nr. 762, datë 15.05.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Afrim Shehu.*

12. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

12.1. *Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit "apartament me sipërfaqe 72,20 m<sup>2</sup>", me vendndodhje në rrugën "{\*\*\*}", Tiranë, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.*

12.2. *Lidhur me pasuritë e paluajtshme të llojit "apartament banimi" dhe "garazh me dy vende parkimi", në rrugën "{\*\*\*}", në Tiranë, Komisioneri Publik kundërshtoi konkluzionin e Komisionit lidhur me këto pasuri dhe pretendoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, duke u ndodhur në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe neni D të Aneksit të Kushtetutës.*

12.3. *Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit "apartament me sipërfaqe 96,5 m<sup>2</sup>", me vendndodhje në rrugën "{\*\*\*}", Tiranë, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.*

12.4. *Lidhur me analizën financiare të kryer nga Komisioni, Komisioneri Publik kundërshtoi konkluzionin e Komisionit lidhur me disa nga zërat e analizës financiare dhe, në tërësi, lidhur me rezultatin e saj pretendoi se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe neni D i Aneksit të Kushtetutës, duke qenë se edhe pas kalimit të barrës së provës, nuk arriti të justifikojë burimet e tij të ligjshme, të personave të lidhur dhe të tjerë të lidhur me të, për krijimin e pasurive, mbulimin e shpenzimeve dhe kursimeve edhe për vitet 2014-2016, për një pamjaftueshmëri financiare përtej asaj të konstatuar nga Komisioni që kalon kufijtë e proporcionalitetit dhe standardit të vendosur në jurisprudencën e Kolegjit në këtë drejtim, edhe në variantin më të mundshëm garantist në të cilin konsiderohen të gjitha prapësimet e subjektit të rivlerësimit.*

13. *Sa i takon kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioneri Publik pretendoi se, në zbatim edhe të rekomandimit të ONM-së të datës 30.09.2024, përveç sa konstatuar nga Komisioni, duke iu referuar këtu gjetjeve të këtij të fundit lidhur me denoncimet e shtetasit D.P., subjekti i*

rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse mbi gjetjet e rezultuara lidhur me denoncimet e shtetasit S. Sh., E. M. dhe O. V., duke afektuar respektivisht indikatorët e parashikuar në nenet 75, 74, pika 4 dhe 73, pika 2 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016). Sipas Komisionerit Publik, gjetjet e rezultuara gjatë hetimit administrativ, janë të tilla që bien ndesh me vlerat themelore të pritura nga një magjistrat, siç parashikohet në nenin 3, pika 5 e ligjit nr. 96/2016 dhe udhëzimet ndërkombëtare që rregullojnë sjelljen e magjistratëve, si brenda dhe jashtë sistemit të drejtësisë, duke bërë që subjekti të gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

#### **IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit**

##### *A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit*

##### *a) Juridiksioni i Kolegjit*

14. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit Afrim Shehu, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

##### *b) Legjitimimi i Komisionerit Publik si ankues*

15. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh<sup>5</sup> nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

##### *c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

16. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ankimi kundër vendimit të Komisionit i ushtruar nga Komisioneri Publik, shqyrtohet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt

---

<sup>5</sup> Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 762, datë 15.05.2024, për rivlerësimin e subjektit Afrim Shehu, i është njoftuar Institucionit të Komisionerëve Publikë më datë 30.09.2024, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., të së njëjtës datë, kurse ankimi i Komisionerit Publik është depozituar pranë Komisionit më datë 11.10.2024, protokolluar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 11.10.2024, që rezulton të jetë dita e 11-të e afatit ligjor për të ushtruar ankim në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

gjykimi u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në prani të palëve në datat 20.03.2025, 02.04.2025, 22.04.2025 dhe 05.05.2025.

17. Trupi gjykues, për shkak të mbarimit të mandatit kushtetues të Institucionit të Komisionerëve Publikë, në zbatim të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës<sup>6</sup> dhe nenit 199, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile, në seancën gjyqësore të datës 20.03.2025, vendosi kalimin procedural nga Komisioneri Publik te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, i cili u përfaqësua në këtë gjykim nga z. Klodjan Braho, prokuror pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, sipas autorizimit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, nr. {\*\*\*} prot., datë 02.04.2025.
18. Në seancën e datës 02.04.2025, në parashtrimet e tij lidhur me ankimin, përpara Kolegjit, të paraqitura edhe me shkrim, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, z. Klodjan Braho, deklaroi se Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme u qëndron të gjitha shkaqeve të ankimit të ushtruar në datën 11.10.2024 nga Komisioneri Publik kundër vendimit nr. 762, datë 15.05.2024, të Komisionit, për kriterin e kontrollit të pasurisë, ndërkohë që heq dorë nga shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, në mbështetje të nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, nenit 44 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar dhe nenit 463 të Kodit të Procedurës Civile.
19. Në vijim të kërkesës së subjektit të rivlerësimit drejtuar trupit gjykues gjatë seancës së datës 02.04.2025, për riçeljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin si provë shkresore të akteve të depozituara gjatë parashtrimeve në Kolegji, trupi gjykues, pasi dëgjoi shpjegimet e palëve, në funksion të shqyrtimit të çështjes, me vendim të ndërmjetëm, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenet 45 e 49, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, vendosi:
  - *Të çelë hetimin gjyqësor dhe të administrojë në cilësinë e provës aktet e listuara në procesverbalin e seancës gjyqësore, përjashtuar kopjen e analizës financiare për periudhën 2009 – 2016, në formatin A3, e printuar nga raporti i ekspertit kontabël i dorëzuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.*
  - *Të mos çelë hetimin gjyqësor për denoncimet e publikut të depozituara në Kolegji pas depozitimit të ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit objekt kontrolli, pasi ato nuk plotësojnë kërkesat e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.*

*B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material*
20. *Lidhur me shkakun e ankimit për deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm nga subjekti i rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme të llojit “apartament me sipërfaqe 72,20 m<sup>2</sup>” me vendndodhje në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konstatoi sa më poshtë.*

---

<sup>6</sup> Referuar parashikimit të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës, me mbarimin e mandatit kushtetues të Institucionit të Komisionerëve Publikë, kompetencat e tyre ushtrohen nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

21. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së krijimit të kësaj pasurie të paluajtshme dhe mjaftueshmërisë së deklaramit të subjektit të rivlerësimit, ka konkluduar se të ardhurat nga paga dhe kursimet e subjektit dhe bashkëshortes, duhet të përfshihen si burim për pagesën e kësteve të apartamentit dhe, në vijim të analizës financiare të kryer prej tij, Komisionit i ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi të kryejë pagesën e këstit të fundit me të ardhura të ligjshme. Komisioni, për pasurinë apartament të ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, me rezultatet e hetimit, i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për pamundësinë financiare për blerjen e apartamentit në shumën totale (-) 3.844.008 lekë, por pas përcjelljes së parashtrimeve dhe dëgjimit të subjektit në seancën dëgjimore, Komisioni ka konkluduar se subjekti arriti të shpjegojë në mënyrë shteruese, bindëse dhe të mbështetur në dokumentacion, duke e reduktuar pamundësinë financiare për këtë pasuri vetëm në vlerën e këstit të parë prej (-) 982.558 lekësh.
22. Komisioneri Publik në zbatim të rekomandimit të ONM-së e kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me pasurinë objekt kontrolli, duke pretenduar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me këtë pasuri duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë ka rezultuar me pamjaftueshmëri të burimeve financiare për: (i) pagesën e këstit të parë, për të gjithë shumën në vlerën 9.040 USD, (ii) pagesën e këstit të dytë deri në datën e pagimit të tij, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të mobilimit (përlllogaritur në shumën 4,1 milionë lekë). Sipas Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime kontradiktore dhe është përpjekur të paraqesë ndryshe burimet e ligjshme të krijimit të kësaj pasurie, duke ndryshuar deklaramitin nga dhurim në shumën 10.041 euro nga vëllai i tij A. Sh., deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, në hua nga z. G. Zh., në shumën prej 4.000 USD, deklaruar gjatë hetimit administrativ.
23. Në mbështetje të këtij shkakut ankimi, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me:
- 23.1. Burimin e të ardhurave nga puna e tij si avokat përgjatë periudhës 10.04.2002- 31.12.2003, deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* në shumën 2.518.333 lekë. Lidhur me këto të ardhura të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioneri Publik pretendoi se në mesin e burimeve të ligjshme të të ardhurave nga punësimi i subjektit si avokat, vetëm vlera e konfirmuar nga institucionet zyrtare, në shumën 956.340 lekë, është shumë e cila plotëson standardin e vendosur nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, neni 32 pika 1, neni 49 pika 4 dhe neni 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudenca e konsoliduar e Kolegjit në këtë drejtim.
- 23.2. Burimin e të ardhurave me origjinë “dhuratë nga vëllai A. Sh.”, deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, në shumën 10.041 euro, depozituar në datën 02.07.2003, pranë ProCredit Bank. Sipas Komisionerit Publik, kjo shumë, referuar të dhënave nga lëvizjet e llogarisë bankare ku është depozituar, nuk mund të ketë shërbyer si burim për pagesën e këstit të parë të pasurisë, duke qenë se, sipas tij, ka qenë gjendje në bankë deri në datën 03.02.2004, si dhe as si burim për pagimin e kësteve të tjera për apartamentin, për sa kohë nuk rezultoi që kjo vlerë e tërhequr nga banka më datë 03.02.2004, të jetë deklaruar në deklaratën e këtij viti pranë ILDKPKI-së si gjendje *cash*.

23.3. Burimin “Hua në shumën 4.000 USD të dhënë *cash* nga G. Zh. në gusht 2003”, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të Komisionit si burim për pagesën e kështit të parë, si pjesë e një huaje më të madhe prej 23.000 USD e marrë nga bashkëshortja e subjektit nga N. Q., sipas kontratës noteriale të datës 12.9.2005. Lidhur me këtë hua të deklaruar, Komisioneri Publik pretendoi se kjo shumë nuk duhet të merret në konsideratë në mesin e burimeve të ligjshme dhe në analizën për blerjen e apartamentit në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, pasi ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar deklarinimin mbi burimin e pagesës së kështit të parë të apartamentit, duke e deklaruar këtë shumë si burim për herë të parë vetëm gjatë hetimit administrativ, ndërkohë që në deklaratën para fillimit të detyrës, shuma prej 23.000 USD është deklaruar nga bashkëshortja e subjektit si burim për një apartament tjetër, atë në rrugën “{\*\*\*}”. Komisioneri Publik pretendoi se deklarinimet e subjektit lidhur me këtë hua janë bërë në funksion të përmbysjes së barrës së provës, nisur edhe nga fakti se shumata e deklaruara nuk përputhen në vlerë dhe në monedhë, si dhe se në kontratën e huasë së vitit 2005 lidhur midis N. Q. dhe bashkëshortes së subjektit nuk përmendet kjo shumë (4.000 USD) apo mënyra e shlyerjes së saj.

23.4. Lidhur me burimin e deklaruar “Të ardhura nga emigrimi në Greqi dhe firmat piramidale”, Komisioneri Publik pretendoi se këto të ardhura të deklaruara nuk mund të përfshihen në mesin e burimeve të ligjshme të analizës financiare, duke qenë se nuk plotësojnë standardet e vendosura nga Kolegji për vlerësimin si të ardhura të ligjshme. Edhe sa u përket të ardhurave të pretenduara nga firmat piramidale, deklaruar me burim nga të ardhurat nga emigracioni, Komisioneri Publik pretendoi se përveçse mbetet i paprovuar burimi i ligjshëm i tyre, ato duket se janë shtuar si një burim për krijimin e pasurisë objekt kontrolli, duke u deklaruar në një fazë të avancuar të hetimit administrativ, me qëllim përmbysjen e barrës së provës. Komisioneri Publik parashtroi në ankimin e tij se në variantin më garantist, të ardhurat nga firmat piramidale të padeklaruara më parë nga subjekti, edhe nëse merren në konsideratë, do të jenë në shumën 143.113 lekë në vend të 873.113 lekë marrë nga Komisioni<sup>7</sup>.

23.5. Lidhur me e burimet e të ardhurave për pagesën e kështit të dytë prej 10.000 USD në datë 13.09.2005, kështit të tretë prej 1.270.000 lekësh në datë 02.10.2005 dhe pagesat *cash* për mobilimin prej 239.000 lekësh, Komisioneri Publik pretendoi se në analizë të shumave të dhuruara nga vëllai i subjektit, ato nuk mund të konsiderohen si burime për shlyerjen e kështit të dytë dhe mbulimin e shpenzimeve shtesë/mobilim gjatë vitit 2005, për sa kohë që në deklaratën periodike të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar këto shuma si kursime në gjendje *cash* në fund të vitit. Komisioneri Publik pretendoi gjithashtu se këto shuma nuk rezultojnë të jenë deklaruar si burim për apartamentin në asnjë prej deklaratave në vitet pasuese, si dhe nuk rezultojnë të jenë deklaruar dhe provuar me akte justifikuese nga subjekti i rivlerësimit, në kuadër të deklarinimit të burimeve të pasurive së bashku me deklaratën *vetting*.

23.6. Komisioneri Publik kundërshtoi periudhën kohore në të cilën është kryer analiza financiare e Komisionit, e cila, sipas tij, duhet të shtrihej deri në datën e kryerjes së pagesës së kështit të tretë

---

<sup>7</sup> Shih poshtëshënimin nr. 19 në faqen 12 të ankimit të Komisionerit Publik.

në tetor të vitit 2005. Në vijim, Komisioneri Publik kundërshtoi si të gabuar mospërfshirjen në analizën financiare të vlerësimit të kursimeve në bankë në shumën 21.000 USD në llogarinë bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, me burim nga depozitimi *cash* i bërë në 10 gusht 2005, mbi bazën e arsytimit se kjo shumë vjen nga shtetasi G. Zh.. Komisioneri Publik pretendoi se rezultati i analizës financiare i kryer deri në momentin e shlyerjes së pagesës së këstit të tretë, duke analizuar edhe shtimin e gjendjes bankare, do të rezultonte me një mungesë të burimeve të ligjshme në vlerën rreth 4,1 milionë lekë.

24. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, kundërshtoi si të pabazuara pretendimet e Komisionerit Publik në mbështetje të shkakut të ankimit për deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë objekt kontrolli, të konfirmuara gjatë gjykimit në Kolegj edhe nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. Sipas subjektit të rivlerësimit, apartamenti në rrugën “{\*\*\*}”, ka si burim krijimi të ardhura të ligjshme dhe, nga analiza financiare, nuk rezultojnë diferenca negative. Diferenca e vitit 2003, në shumën 498.083 lekë, sipas subjektit të rivlerësimit, *bazuar në jurisprudencën e KPA-së dhe parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk përbën shkak për marrjen e masës disiplinore.*
25. Në kuadër të shqyrtimit të shkaqeve të ngritura në ankimin e Komisionerit Publik lidhur me vlerësimin e saktësisë së deklarimit dhe mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për krijimin e pasurisë objekt kontrolli, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të çështjes, trupi gjykues konstatoi fillimisht se në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit në deklarimin e pasurisë objekt kontrolli, ka deklaruar si burim për krijimin e saj: *(i) të ardhurat nga paga si Oficer i Policisë Gjyqësore ndër vite dhe si avokat 10.04.2002 - 31.12.2003; dhe (ii) një vlerë prej 10.041 eurosh, dhuratë nga A. Sh. (vëllai), me banim në Londër, Angli, të depozituara në llogarinë me nr. {\*\*\*}, datë 02.07.2003, në emër të Afrim Shehu, pranë ProCredit Bank, Tiranë.* Ndërkohë që gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti konstatohet të ketë pretenduar si burime për krijimin e kësaj pasurie edhe: *(i) hua në shumën 4.000 USD të dhënë cash nga G. Zh. në gusht 2003; dhe (ii) të ardhura nga emigrimi në Greqi dhe firmat piramidale.*
26. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi të marrë në analizë burimet e pretenduara për krijimin e pasurisë objekt kontrolli (si ato të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe ato të pretenduara gjatë hetimit administrativ në Komision). Nga kontrolli i ushtruar vendimit të Komisionit mbi bazën e shkaqeve të ngritura në ankim për nevoja të kësaj analize, pasi mori në shqyrtim aktet e fashikullit të çështjes, si dhe vlerësoi pretendimet e palëve gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, lidhur me burimet e pretenduara për krijimin e kësaj pasurie, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.
  - *Lidhur me të ardhurat e subjektit të rivlerësimit të deklaruara me burim nga puna si avokat përgjatë periudhës 10.04.2002 - 31.12.2003:*
27. Komisioni, në vendimin objekt ankimi, ka arsyetuar lidhur me këto të ardhura të deklaruara nga ana e subjektit të rivlerësimit se në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, ka rezultuar e provuar se subjekti ka ushtruar profesionin e avokatit për periudhën 2002 – 2003,

duke përfituar edhe të ardhura, të cilat janë provuar pjesërisht nga institucionet shtetërore si të ardhura nga paga. Meqenëse nga hetimi administrativ është provuar vetëm marrëdhënia e punësimit pranë zyrës së avokatisë, në analizën e Komisionit janë përfshirë si të ardhura të ligjshme vetëm të ardhurat nga ky aktivitet dhe jo ato të pretenduara si të krijuara nga angazhimi pranë zyrës së noterisë që i përkiste bashkëshortes së vëllait. Komisioni vlerësoi gjithashtu se për shumën 1.400.000 lekë të fituar si shpërblim, nuk u arrit të provohej shlyerja e detyrimeve tatimore të paguara mbi këto të ardhura, por meqenëse në kontratën e punës të lidhur me zyrën e avokatisë parashikohej 20% fitim për klientët e përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit (*success fee*), Komisioni rezultoi të ketë përfshijë në analizën e tij financiare si të ardhur të subjektit të rivlerësimit 20% të xhiros së vitit 2002 dhe 20% të xhiros së vitit 2003, pas llogaritjes së kryer me marzh fitimi 80% të xhiros së deklaruar<sup>8</sup> nga zyra e avokatisë. Në përfundim, Komisioni ka përfshirë respektivisht vlerat 320.000 lekë për vitin 2002 dhe 297.600 lekë për vitin 2003. Trupi gjykues vëren se të ardhurat totale që përmbushin, sipas Komisionit, kriteret e burimit të ligjshëm sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe që janë përfshirë në analizën financiare të këtij të fundit janë në shumën 1.573.940 lekë.

28. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në kundërshtim të konkluzionit të mësipërm të Komisionit dhe në mbështetje të shkakut të ngritur nga Komisioneri Publik në ankim, parashtrroi se vetëm vlera e konfirmuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në shumën prej 956.340 lekësh, plotëson standardin kushtetues dhe ligjor për t'u vlerësuar e ardhur e ligjshme. Ndërsa lidhur me vlerësimin për shumën 1.400.000 lekë të deklaruar si të fituar nga shpërblimi në kuadër të parashikimit në kontratën e punës, ankuesi pretendoi se bazuar në dokumentacionin e depozituar nga subjekti i rivlerësimit mbi qarkullimin/xhiron e deklaruar nga zyra e avokatisë të vëllait të tij, ka rezultuar se në vitin 2002 xhiro ishte 2.000.000 lekë dhe në vitin 2003 xhiro ishte 1.800.000 lekë, kështu që shuma e pretenduar prej 20% të fitimit (sipas kontratës) do të rezultonte ndjeshëm më e ulët se e ardhura e pretenduar prej 1.400.000 lekë. Sipas tij nuk provohet as transaksioni i pagesës së kësaj shume, si dhe gjatë hetimit administrativ nuk rezultoi të jetë provuar as pagesa e detyrimeve tatimore mbi këtë të ardhur të pretenduar, e cila në çdo rast sipas ankuesit, referuar ligjit për tatimin mbi të ardhurat dhe udhëzimet në funksion të tij, do të duhej të tatohej si e ardhur e përfituar nga vetë subjekti i rivlerësimit.
29. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me burimin e të ardhurave nga *puna e tij si avokat përgjatë periudhës 10.04.2002- 31.12.2003*, prapësoi para Kolegjit se të ardhurat e deklaruar sipas vërtetimit të lëshuar nga punëdhënësi në shumën 2.518.333 lekë, deklaruar rregullisht sipas tij si në deklaratën e pasurisë *vetting*, ashtu edhe në deklaratën para fillimit të detyrës, duhet të vlerësohen nga Kolegji si të ardhura të ligjshme në vlerën e plotë të tyre, sipas vërtetimit të punëdhënësit, dhe të përfshihen si të tilla në analizën financiare të kryer në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit pretendoi se gjatë procesit të rivlerësimit, rezultoi e provuar: (i) marrëdhënia e punësimit nga ku janë realizuar këto të ardhura, sipas kontratës së

---

<sup>8</sup> Duke referuar se sa më sipër është sipas praktikës së Komisionit dhe Kolegjit mbi të ardhurat nga ushtrimi i veprimtarisë së avokatisë.

punës të lidhur me zyrën avokatore në të cilën parashikohet se përveç pagës subjekti do të përfitonte edhe 20% të të ardhurave nga xhiro; dhe se (ii) detyrimin ligjor për pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga paga dhe shpërblimet e ka pasur vetëm punëdhënësi, personi fizik (zyra avokatore) në rastin konkret. Në kuadër të kësaj marrëdhënieje punësimi subjekti pretendoi se pagesën e ka marrë me para në dorë *cash* dhe jo nëpërmjet sistemit bankar dhe se ka qenë në mirëbesim, në lidhje me padijeninë e tij mbi xhiron e deklaruar nga zyra avokatore (e cila jo për fajin e tij, duhet të jetë deklaruar edhe më e vogël) apo moskryerjes së pagesave/detyrimeve tatimore. Në mbështetje të pretendimeve të tij lidhur me volumin e lartë të punës së zyrës avokatore ku ka qenë i punësuar dhe, rrjedhimisht, realizimit të një xhiroje reale më të lartë sesa deklaruar pranë organeve kompetente, subjekti i rivlerësimit dorëzoi në Kolegj edhe disa akte<sup>9</sup> të cilat u morën nga trupi gjykues në cilësinë e provës.

30. Pas përfundimit të hetimit gjyqësor, gjatë fazës së bisedimeve përfundimtare, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme mbajti qëndrimin e tij përfundimtar lidhur me këtë burim të ardhurash, sipas të cilit: [...] *në vlerësim të sa më sipër, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit dhe në mbështetje të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit mbi detyrimet e punëdhënësit për pagesën e tatimit në burim, vlerësohet se për qëllime të këtij procesi, si e ardhur e ligjshme nga punësimi i subjektit si avokat pranë studios së avokatisë për periudhën 2002-2003, përtej asaj të konfirmuar nga ISSH-ja duhet të konsiderohet vetëm përfitimi në masën 20% të fitimit nga aktiviteti i studios së avokatisë, bazuar në qarkullimin e deklaruar nga ky aktivitet në organet tatimore për vitet 2002-2003. Bazuar në këtë arsyetim, e ardhura totale nga punësimi pranë studios së avokatisë vlerësohet të llogaritet në vlerën 1.537.940 lekë, shumatore e vlerës së konfirmuar nga ISSH, në shumën 956.340 lekë si dhe 20% e fitimit të studios së avokatisë, bazuar në qarkullimin e deklaruar në organet tatimore, 2.000.000 lekë për vitin 2002 dhe 1.860.000 lekë për vitin 2003, duke konsideruar si fitim 80% të xhiros së deklaruar, referuar jurisprudencës së Kolegjit.*
31. Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të çështjes, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit lidhur me të ardhurat e krijuara me burim punën si avokat në periudhën kohore 10.04.2002 - 31.12.2003, në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës në vitin 2009, në rubrikën e të ardhurave ka deklaruar: *Nga data 10.04.2002 deri më datë 31.12.2003, avokat pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë – 2.500.000 lekë.* Ndërsa në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka deklaruar: *Nga puna si avokat, datë 10.04.2002 - 31.12.2003, në studion ligjore me adresë në rrugën “{\*\*\*}”, pall. {\*\*\*}, Tiranë (NIPT {\*\*\*}), (kontratë pune, datë 10.04.2002 dhe vërtetim i datës 18.01.2017) – 2.518.333 lekë.*
32. Në mbështetje të deklaramit në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në cilësinë e dokumentacionit justifikues, në kuadër të parashikimeve të nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, aktet vijuese: (i) Vërtetim të lëshuar nga z. A. Sh. (vëllai i subjektit të rivlerësimit) më datë 18.01.2017, sipas të cilit vërtetohet se Afrim Shehu nga data 10.04.2002 -31.12.2003, ka

---

<sup>9</sup> 65 vendime gjyqësore të dhëna gjatë harkut kohor të viteve 2002-2003 nga gjykata të rretheve të ndryshme gjyqësore, si dhe 4 deklaratat noteriale. Referoju akteve shkresore të identifikuar me nr. {\*\*\*} - nr. {\*\*\*} dhe nr. {\*\*\*} – nr. {\*\*\*} të listës së provave depozituar në Kolegj bashkëlidhur parashtrimeve me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

ushtruar detyrën e avokatit pranë zyrës së tij të regjistruar në organet tatimore me NIPT {\*\*\*}, dhe se është paguar me një pagë mujore neto prej 55.000 lekësh dhe shpërblime të tjera sipas kontratës së lidhur më datë 10.04.2002. Referuar këtij vërtetimi, subjekti i rivlerësimit ka krijuar të ardhura neto nga paga për periudhën në fjalë gjithsej 1.118.333 lekë dhe të ardhura të tjera, shpërblime dhe punë jashtë orarit në vlerën neto prej 1.400.000 lekësh. (ii) Kontratë pune të lidhur mes z. A. Sh., i cili paraqitet në cilësinë e punëdhënësit i identifikuar me NIPT {\*\*\*} dhe z. Afrim Shehu në cilësinë e punëmarrësit. Referuar nenit 4 të kësaj kontrate është përcaktuar se: *Paga mujore neto, që Punëdhënësi i njej Punëmarrësit, për kryerjen e detyrave të përcaktuara në nenin 1, të kësaj kontrate, do të jetë 55.000 (pesëdhjetë e pesë mijë) lekë. [...] Punëmarrësi, do të shpërblehet me 20% të vlerës së paguar nga klientët e mbrojtur prej tij, si dhe në rastet e punës jashtë orarit dhe ditëve të pushimit, do të ketë shpërblime të tjera mbi pagën e përshkruar më sipër. Paga e Punëmarrësit do të rishikohet çdo gjashtë muaj, në bazë të performancës së detyrave të ngarkuara dhe marrëdhënieve me klientët.* (iii) Në mbështetje të deklarimeve të dhëna për të ardhurat nga avokatia subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë dorëzuar në ILDKPKI, më datë 16.02.2018 edhe një “Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare” të nxjerrë nga Drejtoria e Arkivit Qendror Tiranë më datë 23.12.2017, sipas të cilit vërtetohet se i siguruari Afrim Shehu, për periudhën prej 01.04.2002 deri më 31.12.2003 ka realizuar të ardhura mbi bazën e të cilave janë derdhur kontribute si specifikuar në tabelën përkatëse. Sipas kësaj table nga muaji prill 2002 deri në dhjetor të vitit 2003, sipas deklaramit të kryer nga punëdhënësi në organet kompetente, subjekti i rivlerësimit është paguar me pagë mujore bruto në shumën prej 55.000 lekë të pandryshuar për të gjithë periudhën.

33. Vetë subjekti i rivlerësimit i pyetur nga Komisioni<sup>10</sup> për të sqaruar dhe provuar me dokumentacion ligjor shlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhurat e tjera, komisione, punë jashtë orarit, shpërblime, etj të cilat janë deklaruar në vlerën totale 1.400.000 lekë nga punësimi i tij pranë zyrës së avokatit A. Sh., me NIPT {\*\*\*}, është përgjigjur: *Siç kam deklaruar, unë kam ushtruar profesionin e avokatit nga data 10.04.2002 - 31.12.2003 pranë studios ligjore “{\*\*\*}”, me adresë në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë. Ngjitur me zyrën e avokatisë, ndodhej dhe zyra e notere M. Sh., të cilat ishin ngjitur me njëra-tjetrën. Përveç të ardhurave të deklaruara nga të dy zyrat, më janë ofruar të ardhura të tjera shtesë, si: shpërblime, punë jashtë orarit dhe në ditët e pushimit. Vlera e përfituar nga të dyja zyrat, për të ardhura të tjera shtesë, shpërblime dhe punë jashtë orarit, është vlera 1.400.000 lekë për të gjithë periudhën 10.04.2002 – 31.12.2003. [...] Si dokumentacion për shlyerjen e detyrimeve tatimore nga ana e tyre më është vënë në dispozicion, vërtetim me nr. {\*\*\*}, datë 29.08.2006, i lëshuar nga Zyra e Tatim Taksave Tiranë në të cilin provohet se A. Sh. me NIPT {\*\*\*} ka paguar detyrime tatimore për vitin 2002, për një xhiro vjetore në vlerën 2.000.000 lekë dhe në vitin 2003 për një xhiro vjetore në vlerën 1.860.000 lekë. Dokumenti vërtetim me nr. {\*\*\*}, datë 27.06.2006 i lëshuar nga Zyra e Tatim Taksave Tiranë në të cilin provohet se znj. M. Sh. me NIPT {\*\*\*} për vitin 2002 ka paguar detyrime tatimore për një xhiro në vlerën 7.860.400 lekë dhe për vitin 2003 ka paguar detyrime tatimore për një xhiro në vlerën 7.700.000 lekë. Pra, siç kanë*

---

<sup>10</sup> Shih përgjigjen e pyetjes nr. 5 të pyetësorit nr. 2 të Komisionit, datë 05.06.2023.

*deklaruar avokati dhe noteri, detyrimet tatimore për të ardhurat e tjera “komisione, punë jashtë orarit, shpërblime etj., që janë deklaruar nga ana ime në vlerën totale 1.400.000 lekë”, janë paguar detyrimet tatimore nga studio ligjore e avokatisë dhe e noterisë. Për këtë periudhë, ata kanë paguar detyrime tatimore të dy së bashku për një xhiro në vlerën 19.420.400 lekë. Së bashku me përgjigjet e këtij pyetësi, subjekti ka dorëzuar dhe shkresat e cituara më sipër, përmbajtja e të cilave konfirmohet si referuar nga subjekti.*

34. Referuar akteve të fashikullit të çështjes, konstatohet se nga ana e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Arkivit Qendror, janë konfirmuar me anë të shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 19.09.2023, të njëjtat vlera të pagave mujore bruto si më sipër referuar, të realizuara nga subjekti i rivlerësimit Afrim Shehu, mbi bazën e të cilave konfirmohet se janë derdhur kontributet nga subjekti “{\*\*\*}” me NIPT {\*\*\*}.
35. Në kuadër të rezultateve të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni dhe barrës së provës që i ka kaluar subjektit të rivlerësimit për të provuar pagesën e detyrimeve tatimore lidhur me të ardhurat e deklaruara në shumën e 1.400.000 lekëve, subjekti i rivlerësimit është shprehur ndër të tjera: *[...] Nga analiza e dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ rezulton se: Vërtetohet punësimi im pranë studios ligjore avokatore të z. A. Sh.; kam paraqitur në Komision kontratën e punësimit të lidhur me z. A. Sh.; kam paraqitur vërtetimin e pagës nga punëdhënësi; i kam deklaruar këto të ardhura si në deklaratën vetting ashtu edhe në DPV-në përpara fillimit të detyrës; kam paraqitur të dhëna për qarkullimin edhe të bashkëshortes së z. A. Sh.. Unë jetoja në banesën e tyre dhe për shkak të formimit tim si jurist kam dhënë ndihmën time profesionale në të dyja aktivitetet që ushtronin vëllai dhe kunata, duke qenë se dhe aktiviteti i punës ishte si një biznes familjar. Kam lidhur vetëm një kontratë dhe termat e referencës për shërbimet profesionale që ofroja në zyrën noteriale kanë qenë të njëjta me ato të kontratës së punës së lidhur me z. A. Sh.; [...] siç rezulton nga dokumentet që kam dorëzuar gjatë hetimit administrativ, kunata në këtë periudhë ka pasur qarkullim të lartë të ardhurash të deklaruara në tatime për të cilat ka paguar edhe detyrimet tatimore. Duke qenë se ata ishin bashkëshortë dhe bizneset e tyre të krijuar si persona fizikë (pra që llogaritë e personit fizik barazoheshin me llogaritë individuale të tyre), pagesa për të gjithë punën që kryeja në të dyja zyrat më është dhënë nga A.. Nga ana tjetër në jurisprudencën e KPA-së është konsoliduar qëndrimi se referuar parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, detyrimi për pagimin e tatimit në burim qoftë në kuadër të një marrëdhënieje punësimi apo të një marrëdhënie që rrjedh nga një kontratë shërbimi, bie mbi subjektin tregtar që bën pagesën. Të njëjtin qëndrim subjekti i rivlerësimit ka mbajtur edhe gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj.*
36. Së bashku me prapësimet e tij, subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë depozituar në Komision edhe një shkresë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. {\*\*\*} prot., datë 03.05.2024, me anë të së cilës kërkoi të provojë se përgjegjësia për pagesën e detyrimeve tatimore lidhur me të ardhurat e përfituara ka qenë e subjekteve tatimpaguese pranë të cilëve ka deklaruar se ka ofruar shërbimet e tij (zyrës së avokatisë dhe të noterisë) respektivisht vëllait të tij A. Sh. dhe bashkëshortes së këtij të fundit M. Sh.. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së kësaj shkrese trupi gjykues vëren se shkresa e

depozituar në Komision ka lëndë “kthim përgjigje” dhe lidhet me një shkresë të drejtuar këtij organi nga subjekti i rivlerësimit, e cila është protokolluar me nr. {\*\*\*} prot., datë 30.04.2024, por përmbajtja e së cilës është e panjohur për trupin gjykues, pasi subjekti nuk rezulton ta ketë depozituar një kopje të saj së bashku me përgjigjen e marrë nga organi tatimor. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së saj evidentohet sa cituar në vijim: [...] *Referuar kërkesës suaj, për të ardhurat personale me karakter jo të përhershëm (honorarë) në vlerën 1.400.000 lekë (referuar shkresës suaj), janë të ardhura personale të tatueshme në zbatim të nenit 8, “E ardhura e tatueshme”, germa “g”. Në dispozitat e nenit 33, “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat”, të ligjit të sipërcituar, përcaktohet se është në përgjegjësinë e tatimpaguesit që ushtron veprimtari ekonomike, që në momentin e pagesës të llogaritë, mbajë edhe derdhë në administratën tatimore tatimin për të ardhurat e përfituara nga individët apo jorezidentët të paregjistruar në administratën tatimore.*

37. Nga shqyrtimi i akteve të dorëzuara trupit gjykues gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, në kuadër të nevojës për të provuar të ardhurat e realizuara nga punësimi i tij në zyrën e avokatisë së A. Sh. (vëllait të subjektit) subjekti i rivlerësimit ka depozituar gjithsej 65 vendime gjyqësore të dhëna gjatë harkut kohor të viteve 2002-2003 nga gjykata të rretheve të ndryshme gjyqësore. Në 13 prej këtyre vendimeve konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka qenë avokati që ka përfaqësuar në gjykim interesat e njërës prej palëve ndërgjyqëse, ndërsa në pjesën e mbetur të vendimeve 52 të tilla, palët ndërgjyqëse janë përfaqësuar nga A. Sh. dhe/ose një tjetër avokate që ka ushtruar këtë veprimtari pranë zyrës avokatore të z. A. Sh.. Trupi gjykues vëren gjithashtu se në pjesën më të madhe të këtyre vendimeve paraqiten në zërin e shpenzimeve gjyqësore edhe shpenzimet e përfaqësimit (të cilat konstatohen në vlera monetare modeste), ndërsa në disa prej tyre këto shpenzime nuk referohen. Trupi gjykues konstatoi gjithashtu se subjekti i rivlerësimit në 4 prej këtyre vendimeve gjyqësore ku ka marrë pjesë si përfaqësues me prokurë i një prej palëve ndërgjyqëse, i ka shoqëruar ato edhe me nga një deklaratë noteriale të të përfaqësuarve, të cilët deklarojnë vlerat e paguara zyrës avokatore për shërbimet e ofruara nga avokati Afrim Shehu, deklarime këto të cilat nuk rezultuan të jenë shoqëruar me fatura/mandatpagesa apo marrëveshje/kontrata të lidhura mes zyrës avokatore dhe palëve të treta përfitues të shërbimeve avokatore.
38. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat me burim nga puna si avokat përgjatë periudhës 10.04.2002 - 31.12.2003, të cilat vlerësohen si të ardhura të ligjshme në kuptim të standardit të përcaktuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe në përputhje me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, janë të ardhurat nga pagat e përfituara në kuadër të punësimit të deklaruar pranë zyrës së avokatisë<sup>11</sup>, në masën e konfirmuar gjatë hetimit administrativ nga organet kompetente prej 956.340 lekësh dhe jo shuma e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, prej 2.518.333 lekësh.

---

<sup>11</sup> Identifikuar me NUIS {\*\*\*}.

39. Pavarësisht faktit të provuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë në marrëdhënie pune pranë zyrës avokatore të vëllait të tij, e cila është rregulluar sipas kontratës së punës të lidhur për këtë qëllim, të ardhurat e pretenduara të krijuara nga kjo marrëdhënie punësimi nuk u arrit të provohen se janë krijuar në përputhje me parashikimet kontraktore, më konkretisht: (i) në kontratën e punës rezultoi të jetë përcaktuar një pagë mujore neto në shumën 55.000 lekë, ndërkohë që nga të dhënat e deklarimeve të kryera nga vetë punëdhënësi paga mujore për të gjithë periudhën e punësimit ka rezultuar në shumën bruto prej 55.000 lekësh; (ii) në kontratë rezultoi të ishte përcaktuar se punëmarrësi do të shpërblehej me 20% të vlerës së paguar nga klientët e mbrojtur prej tij, si dhe në rastet e punës jashtë orarit dhe punës gjatë ditëve të pushimit, do të shpërblehej mbi pagën e përshkruar më sipër. Ndërkohë që nga deklaratimet e kryera nga pala punëdhënëse, vëllai i subjektit të rivlerësimit, rezultoi se paga e përfituar nga subjekti i rivlerësimit ishte deklaruar për të gjithë periudhën e punësimit në të njëjtën masë, në masën e pagës bazë, pa asnjë shtesë, pa asnjë rishikim page mbi bazën e performancës, si përcaktuar në kontratën e punës të depozituar nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ, si dhe gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj përmbushja e këtij kushti kontraktual, të paktën në drejtim të punës së kryer nga punëmarrësi që i jepte atij të drejtën e përfitimeve shtesë mbi pagën bazë, nuk u provua, duke qenë se asnjë e dhënë nuk rezultoi në lidhje me përfitimin *de facto* të pagesave të pretenduara.
40. Parashikimet ligjore në fuqi në drejtim të mënyrës së deklarimit dhe pagesës së detyrimeve tatimore në kuadër të ligjit për tatimin mbi të ardhurat personale të individëve në Republikën e Shqipërisë<sup>12</sup>, në kohën e krijimit të të ardhurave objekt kontrolli, u vlerësuan nga trupi gjykues si

---

<sup>12</sup> Në udhëzimin e ministrit të Financave nr. 3, datë 11.02.2002, "Për tatimin mbi të ardhurat", në pikën 2.3.1, "Pagat dhe shpërblimet e tjera në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës", përcaktohet:

"2.3.1 Në këtë kategori të ardhurash përfshihen si pagat, ashtu edhe shpërblimet e tjera në vlerë, që përfitohen dhe që lidhen me vendin e punësimit aktual të individit.

Termi "të ardhura nga pagat" përfshin pagën bazë si dhe të gjitha shtesat mbi pagën bazë që kanë karakter të përhershëm (vjetërsi, vështirësi, largësi vendbanimi, natyrë të veçantë pune apo shërbimi, si dhe shtesat e bëra me aktet ligjore e nënligjore që cilësojnë shprehimisht shtesën).

Termi "shpërblime të tjera" përfshin të gjitha të ardhurat që përfitohen nga rezultatet e punës në vendin e punësimit aktual të individit. Në këtë kategori bëjnë pjesë të ardhurat që merr individit në formë shpërblimi në vendin e punësimit nga: fondi i veçantë, në formë bonusesh, nga fonde të krijuara me akte të ndryshme ligjore, si page e 13-të, apo pagesa të ndryshme të kesaj natyre.

2.3.1.1. Për kategorinë "shpërblime të tjera" të cilat kanë natyrën e: shpërblimeve të dhëna nga pjesëmarrja e individit në komisione, komitete, këshilla, borde drejtuese, këshilla mbikëqyrëse etj..., mënyra e llogaritjes së tatimit mbi të ardhurat personale do të jetë si më poshtë.

a- Kur shpërblimi i përfituar për pjesëmarrje në komisione, komitete, këshilla, borde drejtuese, këshilla mbikëqyrëse etj..., paguhet jashtë qendrës efektive të punës së individit, këto të ardhura taten në masën 10 përqind.

b - Kur shpërblimi i përfituar për pjesëmarrje në komisione, komitete, këshilla, borde drejtuese, këshilla mbikëqyrëse etj..., paguhet në qendrën efektive të punës së individit, këto të ardhura do të taten:

- duke u bashkuar me pagën e muajit përkatës dhe duke u tatuar sipas tabelës nr. 1 bashkangjitur ligjit për rastet kur shpërblimi për pjesëmarrje sipas paragrafit "b" më lart, ka natyrë të përhershme dhe pagesa bëhet në çdo muaj të vitit (pasi shpërblimi merr natyrën e një shtese page e cila jepet në mënyrë të vazhdueshme gjatë çdo muaji të vitit);

tregues i faktit se pagat dhe shpërblimet e tjera të përfituara në kuadër të zbatimit të kontratës së punës së lidhur në dt. 10.04.2002, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, janë vetëm ato të cilat janë konfirmuar nga organet kompetente.

41. Për më tepër, trupi gjykues vlerësoi se edhe pse përlllogaritja, mbajtja dhe pagimi i detyrimeve tatimore që burojnë nga të ardhurat nga paga dhe shpërblimet e tjera nga marrëdhënia e punësimit janë përgjegjësi e palës punëdhënëse, e cila vepron si agjent tatimbledhës në këtë rast, në mungesë të provave lidhur me faktet e pretenduara nga punëmarrësi mbi përfitimin *de facto* të të ardhurave më të larta nga sa deklaruar pranë organeve nga pala punëdhënëse, këto të fundit çmohen se përbëjnë provë të vetme të të ardhurave të përfituara nga subjekti i rivlerësimit. Për më tepër që formulimet e kontratës së punës në këtë drejtim janë të natyrës së përfitimeve të mundshme që lidhen me përmbushjen e disa kushteve, të cilat sikundër u trajtua më sipër nuk rezultoi të jenë provuar nga ana e subjektit të rivlerësimit as gjatë hetimit administrativ në Komision dhe as gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, duke mbetur ky pretendim në nivel deklarativ.
42. Në përfundim të kësaj analize, trupi gjykues e gjeti të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit për përfitimin e shpërblimeve shtesë mbi pagën, të cilat edhe pas paraqitjes së provave të reja prej tij në gjykimin në Kolegj nuk u arrit të provohen. Në këtë kuadër u vlerësua i pabazuar edhe konkluzioni i Komisionit për konsiderimin si të ardhur të ligjshme në favor të subjektit të rivlerësimit edhe të përfitimit në masën 20% të fitimit të krijuar nga aktiviteti i zyrës së avokatisë për vitet 2002 dhe 2003, bazuar në qarkullimin e deklaruar në organet tatimore, pranuar edhe nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në fazën e bisedimeve përfundimtare, për arsye se ky konkluzion nuk mbështetet në parashikimet e kontratës së punës të lidhur më datë 10.04.2002, mes subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e punëmarrësit dhe av. A. Sh. në cilësinë e punëdhënësit, në të cilën përcaktohej se *Punëmarrësi do të shpërblehet me 20% të vlerës së paguar nga klientët e mbrojtur prej tij [...] dhe jo në masën e 20% të fitimit vjetor të zyrës së avokatisë.*
  - *Lidhur me burimin e të ardhurave me origjinë “dhuratë nga vëllai A. Sh.”, deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting, në shumën 10.041 euro, si të depozituara në datën 02.07.2003, pranë ProCredit Bank:*
43. Lidhur me këtë dhurim dhe vlerësimin e ligjshmërisë së këtij burimi, të deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting, për krijimin e pasurisë objekt kontrolli, Komisioni, pasi ka konstatuar se nga *statement*-i i ProCredit Bank ka rezultuar se transfertat ndërkombëtare nga shtetasi A. Sh. janë kryer në llogarinë e subjektit, në datën 5.4.2004, me vlerë 7.000 euro; në datën 17.9.2004, me vlerë

---

- me 10 përqind, për rastet kur shpërblimi për pjesëmarrje sipas paragrafit “b” më lart, nuk jepet në mënyrë permanente dhe pagesa nuk bëhet në çdo muaj të vitit. Pra do të tatonen me 10 përqind, rastet kur pagesa bëhet psh në vartësi të numrit të mbledhjeve (psh bordi mblidhet çdo tremujor apo çdo vit etj.)

Për përcaktimin e të ardhurave të tatueshme të një individi që përfitohen nga pagat dhe shpërblimet e tjera në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës, shpërblimet e ndryshme të dhëna nga punëdhënësi, mblidhen me pagën e muajit përkatës (pagën bazë plus shtesat) dhe tatonen në bazë të tarifave të përshkuara në pasqyrën nr. 1 bashkëngjitur ligjit dhe këtij udhëzimi”.

5.740 euro; dhe në datën 5.10.2005, me vlerë 15.296,8 euro, ka konkluduar se, duke qenë se transfertat hyrëse të kryera në llogarinë e subjektit, me origjinë shtetasin A. Sh., nuk janë kryer në vitin 2003, nuk mund të jenë përdorur për pagesën e apartamentit në këtë vit<sup>13</sup>. Në vijim të analizës lidhur me këtë dhurim, Komisioni është shprehur se nga analiza financiare e kryer për shtetasin A. Sh., ka rezultuar se ai ka pasur mundësi t'i transferojë vlerën totale 12.270 euro vëllait të tij, subjektit të rivlerësimit, pranë ProCredit Bank, në vitin 2004 dhe se mosdeklarimin saktësisht të kësaj shume në deklaratën *vetting* e konsideron si pasaktësi të subjektit, e cila, sipas Komisionit, e parë në harmoni me elementin e provueshmërisë të transfertës së shumës 12.760 euro dhe elementin e provueshmërisë së burimit të ligjshëm të saj, duhet të përfshihet në analizën financiare të subjektit<sup>14</sup>. Komisioni ka arritur në konkluzionin se rezultati financiar i vitit 2004, prej 4.858.629 lekësh, duhet të përfshihet si gjendje *cash* në vitin pasardhës, duke e bazuar këtë konkluzion në arsyetimin se gjatë hetimit i ka rezultuar se: (i) subjekti provoi disponimin real të kësaj gjendjeje pjesërisht nga tërheqja e transfertave të kryera nga shtetasi A. Sh., në shumën 12.760 euro, gjatë vitit 2004 dhe pjesërisht (shuma 2.818.195 lekë) nga tërheqja e gjendjeve bankare dhe depozitave bankare të tij pranë ProCredit Bank, në vitin 2004; (ii) subjekti arriti të provojë se kishte pasaktësi në deklarimin e tij si OPGJ, në vitin 2004, por ai nuk e dispononte si gjendje *cash* vlerën e tyre, e cila i ishte dhënë hua shtetases M. Sh. dhe shtetasit A. Sh. për investime të tyre, të cilat u provuan me dokumentacion; (iii) subjekti, edhe pse jo saktësisht, ka deklaruar në deklaratën *vetting* vlerën 10.041 euro, e cila u provua nga hetimi i Komisionit se ishte mbajtur si depozitë kursimi dhe ishte tërhequr në vitin 2004; dhe se (iv) periudha e kryerjes së këtyre veprimeve rezulton të jetë përpara marrjes së detyrës nga subjekti i rivlerësimit<sup>15</sup>.

44. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, lidhur me deklarimin nga subjekti i rivlerësimit të *dhurimit në shumën 10.041 euro, nga vëllai i tij A. Sh., si të depozituara në datën 02.07.2003, pranë ProCreditBank*, parashtrroi në Kolegj se kjo shumë, referuar të dhënave nga lëvizjet e llogarisë bankare ku është depozituar, ka rezultuar se e ka origjinën nga një depozitim në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit në *cash*, në vlerën 19.000 euro, më datë 2 korrik 2003, pra, jo transfertë nga i vëllai dhe se nuk mund të ketë shërbyer as si burim për pagesën e kësaj të parë të pasurisë, duke qenë se, sipas tij, ka qenë gjendje në bankë deri në datën 03.02.2004, dhe as si burim për pagimin e kësteve të tjera për apartamentin, për sa kohë nuk rezulton që kjo vlerë, e tërhequr nga banka më datë 03.02.2004, të jetë deklaruar në deklaratën e këtij viti pranë ILDKPKI-së si gjendje *cash*, deklarate kjo, e cila, bazuar në parashikimet e nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ka vlerën e provës në këtë proces.
45. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, në lidhje me burimin e të ardhurave me origjinë *“dhuratë nga vëllai A. Sh.”*, në shumën 10.041 euro, pretendoi se z. A. Sh. (vëllai i subjektit) ka kaluar në llogarinë e tij me transfertë bankare, në datën 05.04.2004, shumën 7.000 euro dhe në datën 17.09.2004, shumën 5.740 euro. Ndërsa në datë 28.5.2008 është kaluar me

<sup>13</sup> Referoju paragrafit 25.10.1 në vendimin e Komisionit.

<sup>14</sup> Shih paragrafët 25.27, 25.34 në vendimin e Komisionit.

<sup>15</sup> Për më tepër, shih paragrafin 25.35 të vendimit të Komisionit.

transfertë bankare shuma 2.500 paund. Subjekti pretendoi se këto shuma monetare janë dhurim nga vëllai i tij A., jo vetëm për shkak të vëllazërisë, por edhe për shkak të marrëdhënies shumë të mirë të forcuar midis tyre gjatë kohës kur kanë qenë së bashku emigrantë në Greqi. Subjekti pretendoi se në deklaratën *vetting* nuk është deklaruar burimi për çdo këst, por burimi për gjithë vlerën e apartamentit, prandaj nuk ka se si të zerohet dhurimi si burim krijimi për shkak të pasaktësisë në vlerën e shumës së dhuruar. Sipas subjektit, vlera 10.041 euro, dukshëm është një lapsus (pra, në vend të shumës 12.740 euro është deklaruar gabimisht shuma 10.041 euro) në mënyrën se si subjekti i rivlerësimit ka lexuar dhe interpretuar të dhënat e *statement*-it bankar. Në përfundim, subjekti prapësoi se vlera e dhuruar në vitin 2004, në shumën 12.740 euro, dhe ajo në vitin 2008, në shumën 2.500 paund, përmbushin kushtet për t'u konsideruar të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe, për këtë arsye, ato duhet të përfshihen në analizën financiare, për sa kohë këto shuma të dhuruara janë kaluar me transaksion bankar dhe nuk ka asnjë dyshim apo pretendim as nga Komisioneri Publik për mundësinë e krijimit me burime të ligjshme nga dhuruesi z. A. Sh., aq më tepër që dhurimi është kryer në kohën kur subjekti nuk ka qenë në detyrë.

46. Në kundërshtimin e pretendimit të ankuesit se shumatat e dhuruara nga vëllai i subjektit A. Sh. nuk mund të konsiderohen si burime për shlyerjen e këstit të dytë dhe mbulimin e shpenzimeve shtesë/mobilim gjatë vitit 2005, për sa kohë që në deklaratën periodike të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar këto shuma si kursime në gjendje *cash* në fund të vitit, subjekti i rivlerësimit prapësoi se, deri në fund të vitit 2004, ai ka pasur në dispozicion një shumë totale prej 4.858.629 lekësh, me burim "kursime nga emigracioni", të ardhura nga ushtrimi i veprimtarisë si avokat dhe oficer i policisë gjyqësore, si dhe shumatat e dhuruara nga familjarë të subjektit me banim dhe punë në Mbretërinë e Bashkuar. Këtë shumë, subjekti i rivlerësimit, pretendoi se nuk e ka deklaruar në fund të vitit 2004 si gjendje *cash*, në deklaratën periodike të vitit 2004, për shkak të përdorimit të saj në mënyrë të përkohshme, për qëllime të natyrës familjare në formë huaje. Subjekti pretendoi se mosdeklarimi i kësaj vlere nuk mund të përbëjë indikator për mungesë transparence apo tentativë për fshehje të pasurisë, për sa kohë që vlera ka burim të ligjshëm dhe huadhënia është realizuar brenda rrethit të ngushtë familjar. Sipas subjektit të rivlerësimit, pasaktësitë formale apo mosdeklarimet, që nuk shoqërohen me mungesë burimi të ligjshëm, nuk mund të interpretohen si shkelje që sjellin përgjegjësi disiplinore, për më tepër që legjislacioni i kohës, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk parashikonte detyrime të qarta në lidhje me formën e deklarimit të shumave të huazuara.
47. Lidhur me pretendimin e ankuesit për këtë burim të deklaruar për krijimin e pasurisë objekt kontrolli, pas verifikimeve të kryera në aktet e fashikullit të çështjes, si dhe pas shqyrtimit të arsyetimit të Komisionit lidhur me vlerësimin e dhurimit, në vlerën 10.041 euro, të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* nga subjekti, si dhurim nga i vëllai A. Sh., trupi gjykues konstatoi fillimisht se, sa i takon pamundësisë së përdorimit të dhurimit, të pretenduar si burim për pagesën e këstit të parë të apartamentit, ky është një fakt i konstatuar dhe pranuar edhe nga Komisioni në

konkluzionin e tij përfundimtar lidhur me vlerësimin e pasurisë objekt kontrolli dhe rrjedhimisht një konkluzion i pacenuar nga ankimi.

48. Sa i takon konkluzionit të Komisionit për pranimin e këtij dhurimi si burim për pagesat e kryera për shlyerjen e kësteve të mëpasshme, trupi gjykues konstatoi se, sikundër pretenduar nga ankuesi, shumat e dhuruara subjektit të rivlerësimit nëpërmjet 2 transfertave bankare ndërkombëtare me përshkrim “Nga MR. A.Sh”, përkatësisht në datën 05.04.2004, në shumën 7.000 euro dhe në datën 17.09.2004, në shumën 5.760 euro, janë tërhequr disa ditë pas kalimit të këtyre shumave në llogarinë e subjektit të rivlerësimit, dhe nuk rezultojnë të jenë deklaruar prej tij në deklaratën periodike të vitit 2004, në formën e likuiditetit *cash* gjendje jashtë sistemit bankar.
49. Trupi gjykues vëren se Komisioni e ka bazuar konkluzionin e tij në vlerësimin se, fakti i përdorimit të shumës prej 12.270 eurosh, të dhuruar subjektit të rivlerësimit nga vëllai i tij A. Sh., sipas dy transfertave ndërkombëtare të datave 5.4.2004 dhe 17.9.2004, si burim për pagesën e kryer sipas mandatpagesës së pretenduar në datën 13.09.2005, provohet sipas bindjes së këtij të fundit, i cili ka arsyetuar në favor të pretendimit të subjektit, pasi ka konstatuar fillimisht problematikat në deklaratimet periodike, si pretenduar në ankim edhe nga Komisioneri Publik e në vijim nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.
50. Në kuptim të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se, në analizën për shqyrtimin e këtij shkakui ankimi, merr rëndësi thelbësore vlerësimi i besueshmërisë së shpjegimeve dhe pretendimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur me administrimin prej tij të këtyre vlerave të konsiderueshme monetare, si dhe të pagesave të kryera lidhur me shlyerjen e çmimit të apartamentit.
51. Në kuadër të kësaj analize, pas shqyrtimit të akteve të fashikullit të çështjes, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

51.1. Nga hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se në “Procesverbalin mbi shpjegimet e subjektit të deklaratimit të pasurive”, të përpiluar në datën 15 janar 2016<sup>16</sup>, teksa është pyetur lidhur me krijimin e pasurisë objekt kontrolli mbi arsyen e mosdeklarimit të apartamentit në vitin 2004, duke iu kërkuar edhe dorëzimi i kontratës së sipërmarrjes për përcaktimin e pagesës, si edhe dokumentacion mbi burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka dhënë këto shpjegime: *Kontrata e sipërmarrjes për prenotim apartamenti nuk është deklaruar në vitin 2004, duke qenë se apartamenti nuk ka qenë i regjistruar në pronësinë time. Kam deklaruar vetëm asetet të cilat kanë qenë në pronësinë time të regjistruara. Po ju paraqes kontratë sipërmarrje, datë 30.05.2003, me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, si dhe leje ndërtimi. Si burim krijimi kanë shërbyer të ardhurat ndër vite nga puna. Në të njëjtin procesverbal, i pyetur lidhur me llogarinë rrjedhëse në euro me nr... {\*\*\*} në Procredit Bank, të hapur në datë 05.04.2004 dhe mbyllur në datë*

---

<sup>16</sup> Të administruar me kërkesë të Komisionit, bashkëlidhur shkresës së ILDKPKI-së nr. {\*\*\*} prot., datë 3.3.2021. Ky procesverbal është nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e subjektit deklarues dhe nga inspektore L. Zh., si përfaqësuese e ILDKPKI-së.

11.11.2010, në të cilën në datën 5.4.2004, është derdhur shuma 7.000 euro dhe në datën 17.09.2004, shuma 5.760 euro, si transfertë ndërkombëtare për llogari të subjektit, sa i takon burimit të transaksionit dhe arsyes së kryerjes, subjekti është përgjigjur: *Transaksionet janë kryer nga kunati me banim në Londër, Angli, dhe nga vëllai im me banim në Londër, Angli, në formë dhurate.*

51.2. Nga sa më sipër, trupi gjykues konstaton që në janar të vitit 2016 (para nisjes së procesit të rivlerësimit kalimtar), subjekti i rivlerësimit ka mbajtur qëndrimin që si burim për krijimin e pasurisë objekt kontrolli kanë shërbyer të ardhurat ndër vite nga puna. Për më tepër, edhe pse transferta ndërkombëtare në shumën prej 12.760 eurosh është bërë objekt verifikimi sipas evidentimit në procesverbal, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë shprehur ndonjë qëndrim lidhur me përdorimin e kësaj transferte si burim për pagesën e apartamentit, pasi vihet re se ka deklaruar shprehimisht se burim për krijimin e pasurisë kanë shërbyer të ardhurat ndër vite nga puna. Trupi gjykues konstatoi gjithashtu se kontrata e sipërmarrjes (shkresë e thjeshtë)<sup>17</sup>, e depozituar në vitin 2016 në ILDKPKI, ndonëse përcakton pagesë sipas kësteve, nuk ka të bashkëlidhur asnjë mandatpagesë, ndryshe nga kontrata e depozituar një vit më vonë, së bashku me deklaratën e pasurisë *vetting*, bashkëlidhur së cilës rezultojnë edhe 3 mandatarëkëtimet me data 10.09.2003, 13.09.2005 dhe 10.05.2008 (të paraqitura si fotokopje, që rezultojnë të kenë një vulë noterit, por të pashoqëruar me një vërtetim njësimi me origjinalin, në formën e kërkuar nga ligji<sup>18</sup>).

51.3. Trupi gjykues konstatoi gjithashtu se, në DIPPV-në e vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pagesë të plotë të çmimit të apartamentit që në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes: *E likuiduar që më datë 30.05.2003, në momentin e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes*, dhe jo pagesë me këste, si pretenduar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe gjatë procesit të hetimit në Komision. Deklarimi në deklaratën periodike të vitit 2010 mbi pagesën e plotë të çmimit të apartamentit në vitin 2003 konstatohet të jetë në linjë me kontratën e sipërmarrjes të dorëzuar në janar të vitit 2016 para ILDKPKI-së, e cila nuk shoqërohet nga asnjë mandatarëkëtimi mbi pagesat të kryera me këste, si dhe me qëndrimin e mbajtur në atë moment kohor se burimet e përdorura për krijimin e kësaj pasurie kanë qenë të ardhurat ndër vite nga puna e subjektit. Ndërkohë që lehtësisht konstatohet kontradiksioni mes këtij deklarimi në deklaratën e vitit 2010 me deklarimin e kryer në deklaratën e pasurisë *vetting*, në janar të vitit 2017, dhe dokumentacionin e dorëzuar bashkëlidhur saj mbi mënyrën e shlyerjes me këste dhe burimet e përdorura, si dhe me qëndrimin e mbajtur në vijim gjatë hetimit administrativ mbi ndryshimin e burimeve të përdorura, të cilat ndryshojnë edhe në raport me deklarimin e kryer në deklaratën e pasurisë *vetting*.

---

<sup>17</sup> Ndërkohë që të gjitha kontratat e sipërmarrjes të lidhura nga kjo shoqëri ndërtimi lidhur me apartamente në të njëjtin objekt ndërtimi, të dorëzuara nga vetë subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, në kuadër të të provuarit të mungesës së një trajtimi preferencial në përcaktimin e çmimit të apartamentit, vihet re të jenë kontrata të lidhura përpara noterit.

<sup>18</sup> Shih nenin 129 të ligjit nr. 110/2018, "Për noterinë", i ndryshuar.

51.4. Po ashtu, në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në dokumentacionin justifikues<sup>19</sup>, të dorëzuar më datë 29.01.2017, si dhe në “Kërkesën për administrim dokumentacioni”, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 12.09.2018<sup>20</sup>, subjekti i rivlerësimit ka identifikuar nëpërmjet nënvizimit/evidentimit si të dhëna lidhur me të ardhurat e përdorura si burim për krijimin e pasurisë objekt deklarimi edhe datën e kryerjes së pagesës (dhurimit të pretenduar nga i vëllai), në vlerën 10.041,00 euro, transaksion i datës 10/09/2003, datë kjo, e cila, në pamje të parë korrespondon edhe me datën e mandatarkëtimit të parë nr. 10, datë 10.09.2003<sup>21</sup>, të lëshuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK.

51.5. Ndërkohë, në përgjigje të pyetësorit të dytë, subjekti i rivlerësimit, teksa është pyetur lidhur me mospërputhjet e pagesave për apartamentin, është shprehur: *Saktësoj se si burim për pagesën e kryer sipas mandatit të arkëtimit, datë 10.09.2003, me vlerë 9.040 USD, ka shërbyer një pjesë e vlerës së huasë së marrë cash në vlerën 4.000 dollarë, në muajin gusht të vitit 2003 nga z. G. Zh. dhe pjesa tjetër janë të ardhura nga paga ime si oficer i policisë gjyqësore, si avokat, si dhe nga shpërblimet për punë jashtë orarit në zyrën e avokatisë dhe të noterisë, si dhe një pjesë e kursimeve të cilat i kisha nga puna në emigracion. Deklarimi si burim i vlerës 10.041 euro, si dhuratë nga z. A. Sh. (vëllai im), ka qenë një pasaktësi e imja, në mënyrën se si unë kam lexuar dhe interpretuar të dhënat e statement-it bankar. [...] Shlyerja e kësteve të pasqyruara me mandatarkëtimin, datë 13.09.2005, në vlerën 10.000 USD dhe në datë 10.05.2008, vlera 3.960 USD, janë kryer në cash në arkën e shoqërisë. Si burim për shlyerjen e këstit të datës 13.09.2005, në vlerën 10.000 USD, ka shërbyer dhurata e ardhur më datë 05.04.2004, me vlerë 7.000 euro, nga vëllai im A. Sh., dhe në datën 17.09.2004, me vlerë 5.740 euro. Diferenca e kësaj vlere, së bashku me të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortes D. dhe kursime të tjera që kisha nga puna si avokat (përfshirë dhe shpërblimet dhe punë jashtë orarit), kanë shërbyer për pagimin e detyrimeve të përshkruara në mandatin e datës 02.10.2005, për punimet shitesë prej 1.270.000 lekësh, si dhe për arredim dhe kompletim kuzhine në vlerën 239.000 lekë<sup>22</sup>.*

---

<sup>19</sup> Shih dokumentin e titulluar “Gjendje llogarie nga /Account Status from 1.1.2003 në/to 12.31.2005”, të lëshuar nga ProCredit Bank, në datën 24.01.2017.

<sup>20</sup> Në këtë shkresë subjekti është shprehur: “Mbas dorëzimit të deklaratës, kam mundësuar gjetjen e disa dokumenteve të tjera që i vlerësoj se i shërbejnë krijimit të pasurisë dhe burimeve të krijimit të tyre. Konkretisht, statement të llogarisë bankare me nr. {\*\*\*}, në monedhën euro, nr. {\*\*\*}, në monedhën euro dhe {\*\*\*}, në monedhën USD, në emrin tim. [...] Kontratë huaje nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 12.09.2005, e lidhur me shtetasin N. Q. dhe deklaratë noteriale me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 23.08.2018, e lëshuar nga shtetasi N. Q.. Dua të theksoj se kjo kontratë huaje nuk është deklaruar si burim në deklaratën *vetting*, për arsye se kjo ka qenë e shlyer dhe nuk ka ekzistuar në momentin e dorëzimit të deklaratës *vetting*”.

<sup>21</sup> Në vlerësim të formatit të përdorur nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK në paraqitjen e datës në mandatarkëtimet e pretenduara datë/muaj/vit, dhe ato të përdorura nga ana e bankës ProCredit Bank muaj/datë/vit, data e kryerjes së pagesës sipas mandatarkëtimit, edhe pse pretendohet nga subjekti se ka ndodhur sipas statement-it bankar më datë 10/09/2003, vlerësohet të ketë ndodhur 1 muaj më parë (në 10 shtator 2003) nga transaksioni bankar i evidentuar në statement, i cili rezulton të jetë kryer më datë 9 tetor 2003.

<sup>22</sup> Shih përgjigjen e pyetjes nr. 6 të pyetësorit nr. 2 të Komisionit.

51.6. Në lidhje me tërheqjet e likuiditeteve bankare në vitin 2004, si dhe shkaqet e mosdeklarimit në deklaratën e dorëzuar në ILDKPKI, për këtë vit, të vlerës së lartë të këtyre tërheqjeve, si gjendje *cash* jashtë sistemit bankar në fund të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në prapësimet e tij ndaj rezultateve të hetimit se: *Mbaj mend se në vitin 2003, për shkak se zyrat ku punonin vëllai dhe kunata ishin të vogla, kunata ime ka blerë një apartament të vjetër në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë. Në vitin 2004, ajo ka kryer edhe rinovimin/rikonstruksionin dhe mobilimin e të gjithë këtij apartamenti, fakt i dokumentuar sipas dokumentacionit bashkëlidhur deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 04.05.2024, të znj. M. Sh. dhe, për këtë arsye, i kam huazuar gjithë likuiditetin që kisha kursyer. [...] Ashtu siç rezultoi nga këqyrja e statement-it bankar, unë kam tërhequr gjatë vitit 2004 pothuajse gjithë likuiditetin që kisha në bankë (edhe vlerën e dhuruar nga vëllai im A.), dhe ia kam huazuar për një periudhë të shkurtër kohore kunatës sime të gjithë gjendjen e likuiditetit që kisha kursyer, hua të cilën ajo ma ka kthyer në verën e vitit 2005, kur unë u martova.*

51.7. Komisioni, referuar arsyetimit të tij në vendim, i ka gjetur bindëse dhe të bazuara në prova këto pretendime të subjektit, ndërkohë që trupi gjykues vë re se kjo huadhënieje nuk rezultoi të jetë dokumentuar, si dhe as të jetë deklaruar më parë nga ana e subjektit të rivlerësimit.

Trupi gjykues vëren gjithashtu se, referuar dokumentacionit të dorëzuar nga vetë subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 04.05.2024, apartamenti në rrugën “{\*\*\*}”, i blerë nga vëllai dhe kunata e subjektit (A. dhe M. Sh.), me çmimin prej 100.000 USD, në vitin 2002, sipas kontratës nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., në datë 11.04.2002, figurojnë të jetë shlyer tërësisht në datën 13.02.2003. Gjithashtu, ndryshe nga sa është shprehur subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit të Komisionit si më sipërcituar, referuar akteve të dorëzuara prej vetë subjektit, shitësi është njoftuar nga blerësit A. dhe M. Sh., më datë 13.01.2003, si vijon: *Ju njoftojmë se, në bazë të deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 15.04.2002, në fund të muajit janar 2003 duhet të bëhet dorëzimi dhe lirimi i banesës objekt i kësaj deklarate, sipas kontratës së shitjes. Ju njoftojmë se në fund të muajit do të fillojë punimet një firmë ndërtimi, me të cilën kemi lidhur një marrëveshje. Në analizë sa më sipër konstatuar nga këto akte, trupi gjykues vlerëson se, ndonëse provohet se vëllai i subjektit dhe bashkëshortja e tij kanë kryer investime për blerje pasurie të paluajtshme në vitin 2002, në rrugën “{\*\*\*}”, si dhe ka të dhëna për investime në rikonstruksion të kësaj pasurie, në shkurt të vitit 2003, kryerja e investimeve të tjera në vitin 2004, vlera e tyre apo fakti se për shlyerjen e tyre janë përdorur likuiditetet e subjektit të rivlerësimit, të tërhequra nga sistemi bankar një vit më vonë, në muajt shkurt, prill dhe shtator të vitit 2004, nuk vlerësohet se provohen nga aktet e fashikullit të çështjes. Për më tepër, shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, se kjo shumë e konsiderueshme monetare i është kthyer subjektit nga vëllai dhe kunata e tij, në verën e vitit 2005, duken të pabesueshme edhe në kontekstin e shpjegimeve të dhëna lidhur me nevojën e huasë së marrë po në këtë periudhë nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, kunatit të subjektit, z. N. Q., në shumën 23.000 USD.*

52. Në përfundim të sa më sipër, pretendimi i ankuesit për moskonsiderimin si burim të ligjshëm të likuiditeteve të tërhequra nga llogaritë bankare përgjatë vitit 2004, të pretenduara si gjendje *cash*, pjesë përbërëse e të cilave rezultuan edhe shumat e dhuruara nga vëllai i subjektit të rivlerësimit A. Sh., në shumën totale prej 12.760 eurosh, të pretenduara nga subjekti se janë përdorur për shlyerjen e pagesave të këstit të dytë dhe të shpenzimeve për punime shtesë e arredim, u gjet i drejtë dhe i bazuar në fakte dhe në ligj.
53. Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues mbajti në konsideratë kryesisht faktin se këto likuiditete nuk ishin deklaruar në deklaratën e parë pas fillimit të detyrës së subjektit si oficer i policisë gjyqësore në vitin 2005<sup>23</sup>, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, as si gjendje *cash* në banesë, as si hua dhënë familjarëve të tij. Në vijim të analizës së mësipërme, pretendimet e subjektit të rivlerësimit për mënyrën e pagesës së kësaj pasurie u çmuan të pabesueshme edhe për shkak të kundërshtive të hapura me deklaratimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, si subjekt deklarues në cilësinë e funksionit si prokuror, në të cilën ka deklaruar se apartamenti me adresë në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë është një pasuri *e likuiduar që më datë 30.05.2003, në momentin e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes*, deklaratë kjo e cila, në kuptim të parashikimeve të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ka vlerën e provës në këtë proces.
- *Lidhur me huanë në shumën 4.000 USD, të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit si të dhënë cash nga G. Zh., në gusht 2003, dhe të përdorur si burim për shlyerjen e këstit të parë të apartamentit:*
54. Lidhur me këtë hua dhe vlerësimin e ligjshmërisë së këtij burimi, të pretenduar për krijimin e pasurisë objekt kontrolli, Komisioni ka arritur në konkluzionin se *shpjegimet e subjektit janë bindëse dhe të mbështetura në prova, në përputhje me nenin 32/4, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës, prandaj vlera 4.000 USD, e marrë hua në gusht 2003 nga subjekti, dhe shuma e rezultuar nga vërtetimi për firmat rentiere duhet të përfshihen si burim i ligjshëm në analizën financiare*. Këtë konkluzion, Komisioni e ka bazuar në arsyetimin se, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, ka çmuar se rezulton e provuar nga të dhënat e bankës se subjekti ka përfituar vlerën 15.296 euro me transfertë bankare në llogarinë e tij, në datën 5.10.2005, nga shtetasi G. Zh., vetëm pas një muaji nga nënshkrimi i kontratës së huasë nr. {\*\*\*} rep ., {\*\*\*} kol., datë 12.9.2005, lidhur me shtetasin N. Q. dhe se nga analiza financiare e Komisionit ka rezultuar se ky shtetas ka pasur mundësi të japë vlerën totale të huasë prej 23.000 USD, me burime të ligjshme. Komisioni ka konstatuar se nga hetimi i ka rezultuar se shtetasit N. Q. dhe G. Zh. janë në një marrëdhënie të posaçme brenda familjes, ku, sipas Komisionit, rezulton se vlera totale e huasë është dhënë nga shtetasi G. Zh. sipas mundësive dhe disponibilitetit kohor e fizik të këtij të fundit. Komisioni ka evidentuar gjithashtu edhe faktin se subjekti, në gusht të vitit 2003, kur ka marrë hua vlerën 4.000 USD dhe ka kryer pagesën e këstit të parë, ushtronte

---

<sup>23</sup> Dorëzuar në ILDKPKI në datën 15.03.2005.

profesionin e avokatit, duke nënkuptuar faktin se, sa më sipër, ka ndodhur përpara marrjes së detyrës së prokurorit<sup>24</sup>.

55. Në lidhje me burimin e deklaruar, *“Hua në shumën 4.000 USD, të dhënë cash, nga G. Zh., në gusht 2003”*, në kundërshtimin e shkakut të ngritur në ankim nga Komisioneri Publik dhe të konfirmuar edhe nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, subjekti i rivlerësimit prapësoi se vlera prej 4.000 USD përmbush të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, prandaj duhet të përfshihet në analizën financiare si burim i ligjshëm për blerjen e pasurisë objekt kontrolli. Sipas tij, kjo shumë e marrë hua në vitin 2003 nga shtetasi G. Zh., bashkëshorti i kushërirës së parë të subjektit, e cila ka shërbyer si pjesë e burimit për blerjen e apartamentit, së bashku me vlerën prej 15.296 eurosh, të transferuar në rrugë bankare në tetor të vitit 2005, nga i njëjti huadhënës, përbëjnë shumën totale prej 23.000 USD, të parashikuar në kontratën e huasë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 12.09.2005. Subjekti pretendoi se kjo kontratë është lidhur me shtetasin N. Q. për arsye të marrëdhënies së besimit dhe sigurisë për kthimin e huasë, ndërkohë që dokumentacioni i paraqitur gjatë hetimit dëshmon sipas tij se fondet janë siguruar dhe transferuar nga G. Zh., i cili ka pasur të ardhura të mjaftueshme për ta mbështetur këtë huadhënie. Sipas tij, kjo shumë është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe provohet nga dokumentacion me fuqi të plotë provuese, të krijuar jashtë procesit të rivlerësimit. Përpos kësaj, sipas subjektit të rivlerësimit, huadhënësi ka pasur burime të ligjshme për të justifikuar krijimin e shumës së dhënë hua, fakt ky, sipas subjektit, i pakontestuar nga Komisioneri Publik.

56. Lidhur me vlerësimin e kësaj huaje të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi faktet dhe rrethanat e mëposhtme të paraqitura në rend kronologjik:

56.1. Si konstatuar edhe më sipër në këtë vendim, subjekti i rivlerësimit, në komunikimin e zhvilluar me ILDKPKI-në, në datën 12.09.2018, ka depozituar ndër të tjera edhe kontratën noteriale të huasë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 12.09.2005, të lidhur me shtetasin N. Q. dhe deklaratën noteriale të lëshuar nga ky i fundit nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 23.08.2018. Referuar kontratës së huasë, konstatohet se ajo është lidhur më datë 12.09.2005, mes z. N. Q. në cilësinë e huadhënësit dhe bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. D. Sh., në cilësinë e huamarrëses. Sipas nenit 2 të kontratës, znj. D. Sh. merr nga z. N.Q. shumën 23.000 USD. Kjo kontratë, referuar nenit 4, i shtrin efektet e saj brenda një afati 10-vjeçar, duke filluar ky afat nga data 09.08.2005 deri më 09.08.2015.

56.2. Në deklaratën noteriale si më sipër cituar, z. N. Q. ka deklaruar: *Unë kam ardhur në muajin Gusht të vitit 2003 dhe, kur jam takuar me kunatin, konstatova se ai ishte fejuar dhe po krijonte familjen e tij. Duke qenë se kisha disa kursime nga puna ime në Londër, më ka kërkuar një hua në vlerën 4000 dollarë. Duke qenë se Afrimi, pas emigrimit tim, është përkujdesur për bashkëshorten, dy fëmijët M. dhe E., deri në qershor të vitit 1999 dhe djalin tim E., unë i kam dhënë në formë huaje në muajin gusht të vitit 2003, një vlerë prej 4.000 dollarësh. Më pas, në vitin 2005 po për*

---

<sup>24</sup> Shih paragrafët 25.18 - 25.20 të vendimit të Komisionit.

nevojat e tij ekonomike, i kam dërguar në llogarinë e tij bankare me nr. {\*\*\*}, pranë ProCredit Bank ShA, në Tiranë, në datën 10.05.2005, një vlerë 15.296,00 euro. Kjo shumë është siguruar nga kursime familjare dhe të bashkëshortit të vajzës M., G. Zh., si dhe dërgimi i kësaj shume me sa kujtoj duhet të jetë kryer nga G. Zh.. Duke qenë se në korrik të vitit 2005, kunati im Afrimi ishte martuar dhe kishte krijuar familjen e tij, me qëllim garantimin e kthimit të huasë, kemi rënë dakord që huanë ta formalizojmë me një kontratë para noterit, ku me bashkëshorten e tij D. Sh. kemi formalizuar kontratën me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 12.09.2005, dhe kemi rënë dakord që kthimi i huasë të bëhej në monedhën dollarë, në datën e lidhjes së kontratës, datë 12.09.2005.

56.3. Në përgjigjet e pyetësorit standard të Komisionit, të dërguara nga subjekti i rivlerësimit në datën 21.01.2021, teksta është pyetur nga Komisioni lidhur me borxhe të marra ndër vite, për të cilat, nëse kishte të tilla, përveç deklaramit lidhur me të dhënat e huamarrësit dhe të huasë, duhet të dorëzonte edhe dokumentacion provues lidhur me burimet e ligjshme të të ardhurave të huadhënësve, subjekti rezulton të ketë deklaruar për herë të parë se shuma e pretenduar prej 4.000 USD, është marrë hua nga shtetasi G. Zh., si pjesë e huasë në vlerën prej 23.000 USD, të marrë sipas kontratës noteriale si më sipër cituar<sup>25</sup>.

56.4. Si konstatuar më lart në këtë vendim, gjatë analizës për burimin “*dhurim në shumën 10.041 euro nga vëllai A. Sh.*”, ka rezultuar se, në datën 05.06.2023, në përgjigjet e pyetësorit të dytë të Komisionit, subjekti është shprehur për herë të parë lidhur me përdorimin e kësaj huaje si burim të pjesshëm të pagesës së këstit të parë të apartamentit, përgjigje kjo e ardhur në kuadër të shpjegimeve të dhëna lidhur me gjetjet e Komisionit mbi pamundësinë e përdorimit të shumës prej 10.041 eurosh, të deklaruar si burim për shlyerjen e këstit të parë të apartamentit<sup>26</sup>.

56.5. Në prapësimet e tij ndaj rezultateve të hetimit, lidhur me gjetjet e Komisionit se: (i) *kjo hua me vlerë 4.000 USD, e marrë në gusht të vitit 2003 prej shtetasit G. Zh., nuk është përfshirë në analizën financiare, pasi subjekti e ka deklaruar si burim vetëm gjatë procesit të rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni dhe nuk e ka deklaruar në deklaratën vetting; dhe (ii) në deklaratën para fillimit të detyrës viti 2009, rezulton se bashkëshortja e ka deklaruar shumën e marrë hua prej 23.000 USD (pjesë e së cilës është edhe vlera 4.000 USD e dhënë në gusht 2003), si burim për blyerjen e apartamentit të ndodhur në rrugën “{\*\*\*}” dhe jo si burim për apartamentin në {\*\*\*}, subjekti i rivlerësimit ka dhënë këto shpjegime: Në fakt, si në deklaratën vetting, ashtu edhe në deklaratën para fillimit të detyrës, është deklaruar huaja 23.000 USD nga N. Q.. Kjo hua është materializuar edhe në kontratën e huasë nr. {\*\*\*}/ {\*\*\*} rep./kol., dt. 12.09.2005, të dhënat e kësaj kontrate janë cituar edhe në DPV-në para fillimit të detyrës. Pas nënshkrimit të kësaj kontrate, G. Zh., në zbatim të kontratës së huasë, ka transferuar në llogarinë time bankare shumën 15.296 euro, në muajin tetor 2005, nëpërmjet bankës ProCredit Bank. Nga një përlllogaritje e thjeshtë aritmetike, rezulton se vlera 15.296 euro + 4000 USD është e barabartë ose në shumën e përafërt me shumën 23.000 USD, referuar kursit të këmbimit të përdorur nga ana jonë në momentin kur*

<sup>25</sup> Shih përgjigjen e pyetjes nr. 19 të pyetësorit standard të Komisionit.

<sup>26</sup> Shih analizën në paragrafët nr. 51.5 e në vijim, më sipër në këtë vendim.

kemi dakordësuar marrjen e huasë. Pra, në momentin kur kam dakordësuar huanë me N., në shtator të vitit 2005 (me kunatin tim, i cili jeton në një banesë dhe në një ekonomi familjare me G. në Londër), kemi përlllogaritur huanë e marrë në vitin 2003 dhe, nga përlllogaritjet që kemi kryer, rezultoi që shuma që duhej të transferohej sipas kursit të këmbimit, në përmbushje të kontratës së huasë, ishte në vlerën 15.300 euro dhe kështu ndodhi<sup>27</sup>. [...] Pra, pavarësisht se nuk është deklaruar në mënyrë të drejtpërdrejtë, huaja e marrë në vitin 2003 nga G. Zh., në shumën 4.000 USD, është deklaruar dhe ekzistenca e saj rezulton nga analiza faktike dhe logjike e një sërë dokumentesh me fuqi të plotë provuese, të përpiluara shumë kohë më parë se sa të miratohej ligji nr. 84/2016, pra nuk është deklaruar vetëm gjatë hetimit administrativ të Komisionit.

56.6. Bashkëlidhur prapësimeve dhe në mbështetje të tyre, subjekti i rivlerësimit ka depozituar edhe një deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 27.04.2024, të lëshuar nga z. G. Zh.. Referuar këtij dokumenti, z. Zh. ka dhënë këto deklaratime: Në vitin 1999 kam emigruar në Londër, Angli. Gjatë qëndrimit në Angli, jam njohur me shtetasen M. Q., me të cilën më pas jemi fejuar dhe më datë 07.08.2005 jemi martuar në Shqipëri. Në Angli jetojmë me N. dhe B. Q., E. si dhe dajën e bashkëshortes, z. A. Sh.. [...] Në verën e vitit 2003, kemi ardhur në Shqipëri dhe kemi kaluar së bashku pushimet me Afrimin dhe D., të cilët sapo ishin fejuar. Në këtë moment, për shkak të krijimit të familjes së re, ai donte të blinte një apartament dhe duke qenë se, nga puna në Angli, kisha të ardhura, i kamë huazuar shumën 4.000 dollarë, të cilën e kisha me vete. [...] Më pas, në muajin korrik 2005, kemi ardhur të gjithë si familje në Shqipëri pasi më pas, më datë 31.07.2005, janë martuar Afrimi dhe D., ndërsa unë dhe M. jemi martuar më datë 07.08.2005. Në korrik të vitit 2005, unë, M., N. dhe B. kemi sjellë në Shqipëri një pjesë të kursimeve tona. Pas dasmave, ne jemi nisur me pushime. Vlerën prej 22.600 USD që ngeli pas ceremonisë martesore, e kemi lënë në Shqipëri, me qëllim të përdorej nga A. në aktivitetin e tij të biznesit (avokatisë) apo për nevoja familjare, ashtu siç kisha dakordësuar me të gjatë kësaj periudhe të qëndrimit në Shqipëri. Për shkak se muaji gusht ishte kohë pushimesh, me sa mbaj mend, atë ditë që do të niseshim me pushime apo një ditë më parë, kjo shumë është arkëtuar për pak kohë në llogarinë bankare të D., me qëllim që kur të mbaronte periudha e pushimeve, të tërhiqej për t'ia dhënë A. dhe M. për nevojat e tyre familjare/të biznesit, ashtu siç kishim dakordësuar. Gjithashtu, gjatë kohës së qëndrimit në Shqipëri, erdha në dijeni se Afrimi kishte blerë apartamentin 1+1, por donte të zgjerohej dhe po kërkonte një apartament më të madh<sup>28</sup>, prandaj vendosëm në bisedë edhe me N. që t'i huazonim edhe një shumë tjetër që, së bashku me huanë e dhënë në vitin 2003, u dakordësua në vlerën 23.000 dollarë. Kjo hua u formalizua me kontratën me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 12.05.2005, kontratë të cilën e nënshkroi N. për shkak se, siç e kemi theksuar edhe më sipër, ne jetonim në një ekonomi të përbashkët në Londër dhe N. ishte më i afërt me të dy ne. Pas nënshkrimit të kësaj kontrate, unë kam dërguar me transfertë bankare shumën 15.296 euro, e cila së bashku me shumën 4.000 dollarë, plotësonte vlerën 23.000 USD, të dakordësuar në kontratën e huasë.

<sup>27</sup> Për më tepër, shih paragrafët 37 - 41 të prapësimeve të subjektit ndaj rezultateve të hetimit.

<sup>28</sup> Ndërkohë që rezulton se në këtë periudhë subjekti nuk kishte shlyer ende pagesën e apartamentit të porositur në vitin 2003.

57. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues vëren se huaja e pretenduar në shumën 4.000 USD, si e marrë nga z. G. Zh., në vitin 2003, për nevoja të pagesës së këstit të parë të apartamentit objekt kontrolli, nuk provohet me asnjë dokument shkresor të kohës, dhe as provohet kalimi i kësaj vlere monetare nëpërmjet sistemit bankar. Gjithashtu, edhe në kontratën noteriale të lidhur për huanë e marrë zotit N. Q. nga bashkëshortja e subjektit, znj. D. Sh., në vitin 2005, nuk rezultoi që të përmendet marrja/dhënia e kësaj shume, si pjesë e vlerës totale të huasë sipas kësaj kontrate. Edhe afati kohor nga i cili vlerësohet shtrirja e efekteve të kontratës së huasë, përcaktohet me efekt nga muaji gusht i vitit 2005<sup>29</sup>, dhe jo nga muaji gusht i vitit 2003, siç logjikisht duhet të ishte, sa kohë pretendohet paradhënia e një pjese të shumës objekt huaje sipas kësaj kontrate. Për më tepër, edhe shpjegimet e subjektit lidhur me personin me të cilin pretendohet se ka negociuar marrjen e kësaj shume në formë huaje, janë kontradiktore dhe konfirmohen si të tilla edhe nga deklaratat noteriale të G. Zh. dhe N. Q., çka, në vlerësim të trupit gjykues, krijon bindjen se këto deklarime janë dhënë në funksion të mbështetjes së pretendimeve të subjektit në varësi të qëndrimeve të këtij të fundit gjatë hetimit administrativ. Më konkretisht, rezulton se një herë shfaqet N. Q. si personi të cilit i është kërkuar nga subjekti shuma prej 4.000 USD dhe ai i cili i ka dhënë këtij të fundit këtë shumë të siguruar me kursimet e tij, dhe një herë shfaqet G. Zh. në këtë pozitë (të huadhënësit).
58. Në këto kushte, në mungesë të provave lidhur me marrjen e kësaj huaje, referuar edhe inkonsistencës së subjektit të rivlerësimit në qëndrimet e tij lidhur me këtë çështje, të cilat kanë ndryshuar përgjatë periudhës kohore nga dorëzimi i deklaratës *vetting*, dhe deri në momentin e kundërshtimit të barrës së provës lidhur me rezultatet e hetimit të Komisionit, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i ankuesit se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të përmbysë barrën e provës lidhur me gjetjet e Komisionit në rezultatet e hetimit mbi vlerësimin e këtij burimi të pretenduar për shlyerjen e këstit të parë të apartamentit objekt kontrolli, gjendet i drejtë dhe i bazuar në fakte.
59. Në përfundim të analizës së mësipërme lidhur me huanë e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, në shumën 4.000 USD, si të marrë nga z. G. Zh., në vitin 2003, trupi gjykues e gjeti të drejtë dhe të bazuar pretendimin e ankuesit për moskonsiderimin e kësaj huaje si burim të ligjshëm për pagesën e këstit të parë të apartamentit, pasi arriti në konkluzionin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se kjo shumë ishte pjesë integrale e huasë së marrë sipas kontratës së lidhur nga bashkëshortja e tij, znj. D. Sh., dhe z. N. Q., në shumën prej 23.000 USD, në vitin 2005<sup>30</sup>, nuk u arrit të provohet as gjatë gjykimit në Kolegj. Kjo shumë prej 4.000 USD, e pretenduar si hua, nuk është deklaruar si burim i krijimit të kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë *vetting*, duke u pretenduar si i tillë vetëm gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, dhe nuk gjen pasqyrim as në përmbajtjen e kontratës së huasë së sipërcituar, të datës 12.09.2005. Pretendimi për përdorimin e

---

<sup>29</sup> Ky afat krijon dyshime mbi qëllimin e vërtetë të lidhjes së kontratës së huasë me z. N. Q., i cili duket të ketë qenë justifikimi i depozitimit nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në datën 10.08.2005, e shumës prej 22.600 USD e pretenduar si shumë e G. Zh., e lënë përkohësisht bashkëshortes së subjektit, për t'iu dhënë A. dhe M. Sh. sapo ata të ktheheshin nga pushimet.

<sup>30</sup> Kontratës nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 12.09.2005.

kësaj shume si burim krijimi për pagesën e këstit të parë të pasurisë objekt kontrolli vjen në kundërshtim me deklarin e bërë nga personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. D. Sh., në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2009, në të cilën huaja në shumën 23.000 USD është deklaruar prej saj, si burim për krijimin e një tjetër pasurie “apartament banimi” në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë.

➤ Lidhur me burimin e deklaruar: *Të ardhura nga emigrimi në Greqi dhe firmat piramidale:*

60. Trupi gjykues vëren se, lidhur me të ardhurat nga *emigrimi në Greqi dhe firmat piramidale*, Komisioni ka pranuar si bindës pretendimin e subjektit në shpjegimet e dhëna ndaj rezultateve të hetimit lidhur me barrën e provës që i kishte kaluar lidhur me rezultatin e analizës financiare për pagesën e këstit të parë, për përfshirjen në këtë analizë edhe të të ardhurave nga emigracioni të cilat i ka mbajtur pranë firmave rentiere, sipas vërtetimit përkatës, por nuk duket të ketë arsytuar mbi vlerësimin e ligjshmërisë së këtyre të ardhurave, sipas standardit të përcaktuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës.
61. Në kundërshtimin e shkakut të ngritur në ankim për moskonsiderimin si të ardhura të ligjshme dhe, rrjedhimisht, mospërfshirjen e tyre në analizën financiare për verifikimin e burimeve të ligjshme për pagesën e këstit të parë të apartamentit, subjekti i rivlerësimit prapësoi në Kolegj se të *ardhurat nga emigrimi në Greqi dhe firmat piramidale* janë krijuar me burim të ligjshëm dhe duhen përfshirë në analizën financiare për verifikimin e burimeve të krijimit të pasurisë objekt kontrolli. Sipas subjektit të rivlerësimit, të ardhurat e krijuara gjatë periudhës së emigrimit të tij në Greqi në vitet 1993-1995, të deklaruara në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2009, në shumën 2.000.000 lekë, pavarësisht se nuk janë deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, për shkak të mungesës së dokumentacionit justifikues, fakti i realizimit të tyre është i besueshëm në kontekstin e kohës dhe rrethanave të punës në emigracion, në të cilat ka qenë i përfshirë edhe vëllai i tij. Subjekti pretendoi gjithashtu se një pjesë e kursimeve nga të ardhurat e krijuara në emigracion është depozituar në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK dhe se subjekti ka përfituar prej saj shumën prej 873.113 lekësh, e cila, sipas tij, në përputhje me praktikën e konsoliduar të Kolegjit, duhet të konsiderohet e ligjshme për efekt të analizës financiare, duke qenë se burimi i saj lidhet me kursime të akumuluar përpara ushtrimit të funksionit publik dhe nuk mbart dyshime mbi legjitimitetin. Subjekti pretendoi se posedimi faktik i kësaj shume provohet edhe nga të dhënat e *statement*-it bankar të Fefad Bank (aktualisht ProCredit Bank), ku më datë 18.01.2001 është hapur një depozitë në të cilën janë depozituar një pjesë e kësaj shume në vlerën 3.300 USD.
62. Pas përfundimit të hetimit gjyqësor, gjatë fazës së bisedimeve përfundimtare, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme mbajti qëndrimin e tij përfundimtar lidhur me këtë burim të ardhurash, sipas të cilit: *të ardhurat e pretenduara nga emigracioni, të padeklaruara në deklaratën vetting dhe në mungesë të akteve provuese, për masën e përfituar dhe ligjshmërinë e tyre, nuk plotësojnë kërkesat e parashikuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe, si të tilla, nuk duhet të përfshihen në mesin e burimeve të ligjshme në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të; të ardhurat e pretenduara nga firmat piramidale, referuar jurisprudencës*

*së Kolegjit, edhe pse rezultoi një burim i deklaruar në një fazë të avancuar të hetimit administrativ, vlerësohet se, duke qenë se subjekti i rivlerësimit ka mundur të paraqesë dokumente të lëshuara nga institucione shtetërore që provojnë përfitimin nga huamarrja në firmat piramidale gjatë viteve 1996-1997, të ardhurat në shumën 873.113 lekë duhen konsideruar se plotësojnë kriteret e përcaktuara nga ligji për t'u konsideruar si të ardhura të ligjshme.*

63. Në analizë të sa më sipër konstatuar, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, trupi gjykues e gjeti të drejtë dhe të bazuar në fakte pretendimin e ankuesit se të ardhurat me burim emigracionin, të cilat konstatohen të jenë deklaruar si burim për krijimin e pasurisë objekt kontrolli vetëm gjatë hetimit administrativ dhe, për më tepër, nuk janë deklaruar as në rubrikën e të ardhurave në deklaratën e pasurisë *vetting*, nuk plotësojnë standardin kushtetues të përcaktuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe jurisprudenca e konsoliduar e Kolegjit, në interpretimin e konceptit të ligjshmërisë së të ardhurave me burim emigracionin, për sa kohë rezultoi se edhe pas gjykimit të çështjes në Kolegji, nuk u provua as punësimi i subjektit të rivlerësimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, as vlera e të ardhurave të pretenduara si të krijuara nga emigracioni, mënyra e kalimit të tyre nga vendi i huaj në Republikën e Shqipërisë dhe, rrjedhimisht, as shlyerja e detyrimeve përkatëse tatimore. Vetë subjekti i rivlerësimit pohoi mungesën e dokumentacionit lidhur me këto të ardhura. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar pretendimin e ankuesit për mospërfshirjen e këtyre të ardhurave në analizën financiare të kryer lidhur me vlerësimin e pagesës së këstit të parë të apartamentit.
64. Në vijim të sa më sipër, në lidhje me pretendimin për konsiderimin si burim për krijimin e pasurisë objekt kontrolli të të ardhurave të përfituara nga firmat rentiere në shumën 873.113 lekë, trupi gjykues e vlerësoi të gabuar konkluzionin e Komisionit për njohjen e tyre, bazuar në shkresën e shoqërive huamarrëse në administrim nr. {\*\*\*} prot., datë 26.03.2024, të pranuar edhe nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në fazën e bisedimeve përfundimtare, dhe vlerësoi të mos e përfshijë këtë shumë si burim financiar të ligjshëm. Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues mbajti në konsideratë pohimin e vetë subjektit të rivlerësimit se vlera monetare e investuar nga ky i fundit në kompaninë rentiere “{\*\*\*}” ShPK, rezultoi se kishte si burim të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga emigracioni, të cilat u vlerësuan se nuk përmbushin standardin kushtetues dhe ligjor të së ardhurës së ligjshme për qëllime të këtij procesi. Në këtë kuptim, për sa kohë nuk u arrit të provohet origjina e ligjshme e të ardhurave të investuara, përfitimet e realizuara sipas shkresës së shoqërive huamarrëse në administrim u vlerësuan se nuk përmbushin standardin kushtetues dhe ligjor të së ardhurës së ligjshme.
65. Në përfundim të analizës së mësipërme, nga kontrolli i ushtruar në Kolegji, lidhur me verifikimin e saktësisë së deklaramit dhe ligjshmërisë së burimeve financiare të krijimit të pasurisë së paluajtshme të llojit “apartament me sipërfaqe 72,20 m<sup>2</sup>”, me vendndodhje në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit, përgjatë procesit të rivlerësimit në Komision, ka ndryshuar burimet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting* për krijimin e kësaj pasurie, fakt ky i cili u mbajt në konsideratë në vlerësimin e saktësisë së deklaramit dhe nivelit të

besueshmërisë në kontrollin e këtij kriteri, përpos konkluzioneve të arritura si më sipër, lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së secilit prej burimeve të marra në analizë.

66. Lidhur me shkakun e ankimit mbi periudhën e analizës financiare të kryer nga Komisioni për vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë objekt kontrolli, trupi gjykues vëren se Komisioni, pasi ka analizuar fillimisht mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për pagesën e këstit të parë, sipas mandatarkëtimit të datës 10.09.2003, sipas një analize pjesore mbi bazën e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën tetor 1999 – tetor 2003<sup>31</sup>, në përfundim, lidhur me këtë pasuri, ka kryer një analizë financiare mbi bazën e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën tetor 1999 – korrik 2005, në të cilën konstatohet të ketë përfshirë si pagesa të kryera për pasurinë objekt kontrolli, pagesat e pasqyruara respektivisht sipas mandatarkëtimit, datë 10.09.2003, në shumën 9.040 USD, mandatarkëtimit të datës 13.09.2005, në shumën 10.000 USD, mandatarkëtimit datë 02.10.2005, në shumën 1.270.000 lekë dhe pagesës për mobilim në shumën 239.000 lekë (pa mandat), në total për këtë periudhë ka përlllogaritur shumën prej 982.558 lekësh si pagesë të këstit të parë në vitin 2003 dhe shumën prej 2.542.300 lekësh si pagesa të kësteve të kryera në vitin 2005. Kjo analizë i ka rezultuar Komisionit me një rezultat financiar pozitiv në shumën 1.888.179 lekë<sup>32</sup>. Në përfundim, Komisioni rezulton të ketë kryer një analizë financiare për të gjithë vlerën e apartamentit, duke përfshirë edhe këstin e fundit sipas mandatarkëtimit datë 10.05.2008, në shumën 3.960 USD, për periudhën tetor 1999 – 10.05.2008, e cila po ashtu ka rezultuar me balancë pozitive<sup>33</sup>.
67. Përcaktimi i periudhës së kryerjes së analizës financiare nga Komisioni, sipas tabelës nr. 4 në faqen 17 të vendimit të Komisionit, dhe rezultati financiar i kësaj analize u kundërshtuan nga Komisioneri Publik në ankim, konfirmuar sa më sipër edhe nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme gjatë shqyrtimit të ankimit në Kolegj, me pretendimin se kjo analizë duhet të shtrihet deri në datën e kryerjes së pagesës së këstit të fundit, në tetor të vitit 2005, duke përfshirë këtu edhe verifikimin e krijimit të kursimeve në bankë, në shumën 22.600 USD, në llogarinë bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, me burim nga depozitimi *cash*, i bërë më 10 gusht 2005. Sipas pretendimit të ankuesit, kryerja e një analize financiare, bazuar në të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën janar 2005<sup>34</sup> – tetor 2005 (deri në datën e pagesës së këstit sipas mandatarkëtimit datë 02.10.2005), do të rezultonte me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për mbulimin e pagesave të apartamentit gjatë këtij viti dhe shpenzimeve/investimeve të tjera të kryera në këtë periudhë, në referim edhe të analizës së paraqitur nga ONM-ja në rekomandimin për ankim, në shumën e 4.150.154 lekëve<sup>35</sup>.

---

<sup>31</sup> Shih tabelën nr. 3 në faqen 14 të vendimit të Komisionit.

<sup>32</sup> Shih tabelën nr. 4, faqe nr. 17 në vendimin e Komisionit objekt ankimi.

<sup>33</sup> Shih tabelën nr. 5, faqe 18-19 në vendimin e Komisionit objekt ankimi.

<sup>34</sup> Referuar këtu edhe pretendimit se likuiditetet e pretenduara si gjendje në fund të vitit 2004 nuk mund të vlerësohen si burim për krijimin e kësaj pasurie për sa kohë nuk ishin deklaruar si të tilla në deklaratën periodike të vitit 2004.

<sup>35</sup> Për më shumë, referoju analizës në faqen 9 të rekomandimit të ONM-së.

68. Në kundërshtimin e këtij shkaku ankimi, subjekti i rivlerësimit prapësoi se shuma prej 22.600 USD, e depozituar përkohësisht në llogarinë e bashkëshortes, në gusht të vitit 2005, nuk përbëhet nga kursime të sajat, por nga kursime të familjes së shtetasit G. Zh., të cilat ata i kanë sjellë në Shqipëri, përpara ceremonisë së martesës së tyre, të lëna nga z. G. Zh.. Subjekti pretendoi se, sa më sipër, provohet edhe nga të dhënat e analizës financiare të kryer nga Komisioni, që nuk u kundërshtua as nga Komisioneri Publik, e cila rezultoi me balancë pozitive në fund të vitit 2004, në shumën 4.828.629 lekë, vlerë kjo e cila, sipas subjektit, mbulon shumën negative të pretenduar nga Komisioneri Publik për pagesën e kësteve të apartamentit në vitin 2005. Sipas subjektit, ai s'ka pasur asnjë arsye të mos thotë të vërtetën për origjinën e shumës së depozituar në llogarinë e bashkëshortes në gusht të vitit 2005, sepse sipas logjikës aritmetike, ky likuiditet, sipas tij, është i mjaftueshëm për pagesën e kësteve të apartamentit dhe shumën e depozituar në llogari bankare. Subjekti pretendoi gjithashtu se kjo depozitë është hapur në datën 10.08.2005, sapo kishte mbaruar dasma e subjektit (në datë 31.07.2005) dhe ajo e z. G. Zh. (në datën 07.08.2005). Kjo shumë parash, sipas subjektit të rivlerësimit, do t'i dorëzohej nga G. Zh. vëllait të tij A. Sh., por duke qenë se ky i fundit ishte nisur me pushime më datë 08.08.2005 në Malin e Zi, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit me bashkëshorten do të largoheshin me pushime në datën 10.08.2005, u dakordësua mes tyre që kjo shumë të mbahej në një llogari të përkohshme në emër të bashkëshortes së subjektit dhe shuma të tërhiqej kur të ktheheshin nga pushimet, duke iu dorëzuar A. dhe në këtë mënyrë pretendohet të jetë vepruar. Në funksion të shpjegimeve të dhëna më sipër, subjekti i rivlerësimit paraqiti në Kolegj, në cilësinë e provës, të dhënat e marra nga sistemi TIMS lidhur me hyrje-daljet e shtetasve N., B., M., E. Q., G. Zh., M. dhe A. Sh.<sup>36</sup>.
69. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues konstatoi fillimisht se, ndonëse kësti në shumën prej 10.000 USD rezulton të jetë paguar sipas mandatarkëtimit përkatës në datën 13.09.2005 dhe kësti në shumën prej 1.270.000 lekësh rezulton të jetë paguar sipas mandatarkëtimit përkatës në datën 02.10.2005, Komisioni, në mënyrë të pashpjegueshme, ka verifikuar mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të përdorura nga subjekti për kryerjen e këtyre pagesave, sipas mundësisë së kursimit deri në korrik të vitit 2005 (rreth 2-3 muaj para datës së kryerjes së tyre), rrjedhimisht edhe zëri i analizës së Komisionit, në tabelën 4, “Ndryshimi i likuiditeteve në bankë”, nuk përfshin efektin e pretenduar nga ankuesi si pasojë e rritjes së likuiditeteve në bankë, nga depozitimi *cash* në datën 10 gusht 2005, nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, në shumën prej 22.600 USD, në llogarinë e saj bankare.
70. Lidhur me depozitim të këtyre likuiditeteve, trupi gjykues, nga verifikimi i lëvizjeve të llogarive bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në ProCredit Bank, konstatoi se kjo e fundit ka depozituar *cash* në llogarinë e saj në datë 10.8.2005, shumën 22.600 USD, dhe ka tërhequr më pas në datën 21.9.2005, shumën prej 1.600 USD dhe një muaj më vonë, në datën 22.10.2005, shumën prej 21.000 USD.

---

<sup>36</sup> Shih shkresën e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë nr. {\*\*\*}, datë 04.03.2025.

71. Trupi gjykues konstatoi gjithashtu se analiza për verifikimin e pagesave të kryera në vitin 2005 rezultoi të jetë kryer në mënyrë kumulative, duke marrë në konsideratë të ardhurat dhe shpenzimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit nga tetori i vitit 1999 deri në korrik të vitit 2005, duke përfshirë në këtë analizë si burime të ligjshme, përpos të tjerave, edhe: (i) të ardhurat nga puna si avokat, në shumën 1.573.940 lekë; (ii) transfertat në ProCredit Bank nga shtetasi A. Sh., në shumën totale prej 1.617.202 lekësh<sup>37</sup>; (iii) huanë, në shumën e 434.760 lekëve<sup>38</sup>, të marrë nga shtetasi G. Zh.; dhe (iv) të ardhurat nga kompanitë rentiere në shumën 873.113 lekë.
72. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vëren se, gjatë hetimit administrativ në Komision dhe gjykimin në Kolegj, nuk u administrua asnjë dokumentacion, sipas të cilit të provohej fakti i pretenduar se shuma e depozituar në datën 10 gusht 2005 nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në llogarinë e saj bankare i përkiste shtetasit G. Zh. dhe as pretendimi se kjo shumë i ishte dorëzuar në vijim vëllait të subjektit të rivlerësimit A. Sh.. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit se kjo shumë monetare i përkiste z. G. Zh. dhe i ishte lënë në ruajtje përkohësisht bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, deri në kthimin nga pushimet të kumatit të saj z. A. Sh., përveçse mbetën në nivel deklarativ, u çmuan të pabesueshme nga trupi gjykues edhe në kontekstin e disponimit të mëpasshëm të kësaj shume, e cila nuk rezultoi të jetë tërhequr e tërë shuma brenda një intervali kohe të arsyeshëm, sipas qëllimit të deklaruar për kohëzgjatjen e pushimeve të A. dhe M. Sh., siç logjikisht duhet të kishte ndodhur në skenarin e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, por përkundrazi rezultoi të jetë tërhequr pjesërisht në datën 21 shtator 2005 me një vlerë modeste prej 1.600 USD dhe pas një periudhe mbi 2-mujore nga data e depozitimit, në datën 22.10.2005 është tërhequr e tërë vlera e mbetur prej 21.000 USD.
73. Trupi gjykues vërejti gjithashtu se, nga dokumentacioni provues i depozituar nga subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimin të çështjes në Kolegj, referuar këtu të dhënave nga sistemi TIMS lidhur me hyrje daljet e vëllait të subjektit A. Sh. dhe bashkëshortes së tij M. Sh., nuk rezultoi që këta shtetas të ndodheshin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në datën 10.08.2005, kur është kryer depozitimi i kësaj shume në llogarinë bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Referuar të dhënave të mësipërme, gjatë vitit 2005, vëllai i subjektit të rivlerësimit A. S. Sh. ka dalë nga territori i Republikës së Shqipërisë më datë 26.11.2005, nga pika kufitare Murriqan dhe ka hyrë në territorin shqiptar në datën 28.11.2005, po nga e njëjta pikë kufitare. Në këtë udhëtim, z. Shehu ka qenë i shoqëruar edhe nga bashkëshortja e tij. Kjo e fundit, gjatë vitit 2005, ka të dhëna edhe për një hyrje-dalje tjetër në periudhën 28.05.2005-06.06.2005.
74. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se pretendimi i ankuesit se analiza financiare për verifikimin e burimeve të ligjshme për pagesat e sipërcituara gjatë vitit 2005 duhet të shtrihet deri në datën e kryerjes së pagesës, sipas mandatarkëtimit të datës 02.10.2005, duke përfshirë edhe krijimin e depozitës në ProCredit Bank, në datën 10.08.2005, në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga depozitimi *cash* i shumës prej 22.600 USD, me të

<sup>37</sup> Ekuivalente e shumës 12.760 euro.

<sup>38</sup> Ekuivalente e shumës prej 4.000 USD.

ardhura të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, ndryshe nga sa është vlerësuar nga Komisioni, me burime nga të ardhurat e z. G. Zh., u gjet i drejtë dhe i bazuar në faktet e provuara gjatë gjykimit.

75. Bazuar në konkluzionet e arritura më sipër në vendim lidhur me analizimin e burimeve të pretenduara për krijimin e pasurisë objekt kontrolli, trupi gjykues vlerësoi se:
76. Pas korigjimit të analizës financiare të kryer nga Komisioni për periudhën tetor 1999 - shtator 2003, për verifikimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit për pagesën e kështit të parë për apartamentin në rrugën “{\*\*\*}”, në datën 10.09.2003, në shumën 9.040 USD, duke përfshirë si të ardhura të ligjshme me burim nga puna e subjektit si avokat vetëm pjesën korresponduese, në shumën prej 819.720 lekësh<sup>39</sup>, duke mos marrë në konsideratë si të ardhura të ligjshme: (i) shumën e pretenduar si të përfutur nga investimi në kompanitë rentiere ({\*\*\*} ShPK), dhe (ii) huanë e pretenduar si të marrë në vitin 2003 nga z. G. Zh., në shumën 4.000 USD, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë të burimeve të ligjshme në shumën (-) 3.457.984 lekë, për pagesën e kështit të parë të apartamentit, krijimin e shtesave të likuiditeteve në bankë, si dhe kryerjen e shpenzimeve për këtë periudhë. Bazuar në analizën e mësipërme, trupi gjykues e gjeti të drejtë pretendimin e ankuesit se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për pagesën e kështit të parë në datën 10.09.2003, për të gjithë vlerën e tij, në shumën prej 9.040 USD<sup>40</sup>.
77. Nga kontrolli i kryer analizës së Komisionit mbi verifikimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit për kryerjen e pagesave për apartamentin objekt kontrolli gjatë vitit 2005, sipas një analize financiare mbi bazën e vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve/investimeve të kryera për periudhën 01.01.2005 - 02.10.2005, duke përfshirë si shtesë likuiditeti në sistemin bankar edhe gjendjen në datën 02.10.2005 të llogarisë bankare të bashkëshortes së subjektit në ProCredit Bank, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të rezultuan me mungesë të burimeve të ligjshme në shumën (-) 4.150.154 lekë. Bazuar në analizën e mësipërme, trupi gjykues e gjeti të drejtë pretendimin e ankuesit se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për pagesën e kështit të dytë, në shumën prej 10.000 USD, në datën 13.09.2005, dhe të shpenzimeve për punime shtesë dhe arredim, përkatësisht në shumat 1.270.000 lekë, në datën 02.10.2005 dhe 239.000 lekë, për të gjithë vlerën e shpenzuar në total prej 2.542.300 lekësh<sup>41</sup> në këtë vit.
78. Në përfundim të analizës së mësipërme, për burimet e krijimit të pasurisë së paluajtshme “apartament me sipërfaqe 72,20 m<sup>2</sup>”, me adresë në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, trupi gjykues arriti në

---

<sup>39</sup> Përlllogaritur shuma 409.860 lekë në vitin 2002 dhe shuma 409.860 lekë (të ardhurat pjesore nga paga neto si avokat 01.01.2003-tetor 2003), total për periudhën 2002-tetor 2003, shuma prej 819.720 lekësh.

<sup>40</sup> Konvertuar në shumën 982.558 lekë sipas vendimit të Komisionit.

<sup>41</sup> Vlera e kështit të dytë në shumën prej 10.000 USD e konvertuar në shumën 1.033.000 lekë, vlera e shpenzuar për punime shtesë në shumën 1.270.000 lekë, si dhe vlera e shpenzuar për mobilim në shumën 239.000 lekë, total në shumën 2.542.300 lekë (1.033.000 lekë + 1.270.000 lekë + 239.000 lekë = 2.542.300 lekë).

konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe është ndodhur në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në shumën totale prej 3.524.558 lekësh<sup>42</sup>, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

79. Lidhur me shkaktun e ankimit për deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm nga subjekti i rivlerësimit të pasurive të paluajtshme të llojit “apartament banimi” dhe “garazh me dy vende parkimi”, në rrugën “{\*\*\*}”, në Tiranë, duke u ndodhur në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit D të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.
80. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, lidhur me vlerësimin e këtyre pasurive të paluajtshme të ndodhura në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, ka konkluduar se: *subjekti është në pamundësi financiare për blerjen e apartamentit në rr. “{\*\*\*}” me të ardhura të ligjshme (në shumën (-) 6.504 euro<sup>43</sup> ose rreth (-) 892.099 lekë)<sup>44</sup> dhe në pamundësi të kryerjes së pagesës së blerjes së garazheve me të ardhura të ligjshme, në shumën [(-)1.677.880 lekë ose rreth (-)12.232 euro]<sup>45</sup>. Këtë konkluzion, Komisioni e ka bazuar në arsyetimin në vijim: Komisioni vlerësoi se, duke u mbështetur në praktikën e tij, analiza financiare duhet përditësuar, duke përfshirë si çmim blerjeje për apartamentin vlerën e përcaktuar në kontratën e shitjes, me të cilën është bërë edhe regjistrimi i apartamentit pranë zyrave të kadastrës. Gjithashtu, subjekti arriti të provojë me dokumentacion ligjor, në të cilin përfshihet deklarimi i të gjitha palëve, se vlera totale e këtij transaksioni (blerja e apartamentit) është në shumën 61.800 euro dhe jo më shumë. [...] Në lidhje me vlerësimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie, Komisioni ka arritur në konkluzionin se: [...] vjehri i subjektit të rivlerësimit ka pasur mundësi të japë shumën 40.000 euro me të ardhura të ligjshme. Kjo vlerë do të përfshihet si burim krijimi për blerjen e apartamentit në analizën e Komisionit. Ndërsa, në lidhje me vlerën e transfertës në llogarinë e subjektit pranë Alpha Bank, në datën 5.3.2009, nga dërguesi B. F., Komisioni vlerësoi se për këtë vlerë, është arritur elementi i provueshmërisë, por Komisioni çmon se nuk do të përfshihet si burim për krijimin e apartamentit, pasi subjekti nuk e ka deklaruar këtë vlerë as në deklaratën vetting dhe as në deklaratat periodike.*
81. Komisioneri Publik kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e mësipërm të Komisionit lidhur me këto pasuri, duke pretenduar se:

➤ Lidhur me krijimin e apartamentit të banimit në rrugën “{\*\*\*}”, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me:

81.1. Përcaktimin e vlerës së paguar për pasurinë, për të cilin Komisioneri Publik pretendoi se vendimi i Komisionit është i paqartë dhe i pambështetur në aktet në dosje, për sa kohë që nga

---

<sup>42</sup> Kësti i parë në shumën 9.040 USD, konvertuar në shumën 982.558 lekë; kësti i dytë në shumën 10.000 USD, konvertuar në shumën 1.033.000 lekë; vlera e shpenzuar për punime shtesë në shumën 1.270.000 lekë, si dhe vlera e shpenzuar për mobilim në shumën 239.000 lekë, totali në shumën 3.524.558 lekë.

<sup>43</sup> Komisioni në poshtëshënimin nr. 59, në faqen 27 të vendimit është shprehur: 61.800 euro – 15.296,4 euro – 40.000 euro = 6.504 euro.

<sup>44</sup> Shih paragrafin 26.20.14 në vendimin e Komisionit.

<sup>45</sup> Shih paragrafin 27.9 në vendimin e Komisionit.

hetimi administrativ dhe aktet e vëna në dispozicion nga subjekti ka rezultuar se për këtë pasuri është paguar të paktën shuma prej 61.800 eurosh, sipas kontratës së shitjes me rezervë, nr. {\*\*\*}/{\*\*\*}, të datës 4.6.2008, plus shuma prej 18.000 eurosh, sipas preventivit dhe mandatarëkëtimit të datës 13.10.2009. Komisioneri Publik pretendoi gjithashtu që mbeti e paprovuar nga hetimi në Komision se diferenca në çmim ka ardhur si rezultat i punimeve shtesë të kryera me kërkesë të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Sipas Komisionerit Publik, si kosto totale për blerjen e apartamentit objekt kontrolli duhet të përcaktohet vlera prej 61.800 eurosh, sipas kontratës së shitjes me rezervë nr. {\*\*\*}/{\*\*\*} të datës 4.6.2008, së bashku me shumën prej 18.000 eurosh, sipas preventivit dhe mandatarëkëtimit të datës 13.10.2009, dhe kjo vlerë të merret në analizë deri në datën e dorëzimit të deklaratës para fillimit të detyrës së subjektit si prokuror, 24.12.2009.

**81.2.** Mundësinë e dhuruesit, shtetasit P. Gj., për të krijuar me burime të ligjshme shumën e deklaruar të dhuruar, prej 40.000 eurosh, për të cilën Komisioneri Publik pretendoi se, për efekt të këtij procesi, vetëm të ardhurat nga pensioni për periudhën 2003 - mars 2008, mund të merren në konsideratë, pasi të ardhurat e tjera përpara kësaj periudhe, janë të pamjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e jetesës. Në çdo rast, sipas Komisionerit Publik, këto të ardhura nuk arrijnë të përmbysin balancën negative të konstatuar nga Komisioni për personin tjetër të lidhur, P. Gj..

**81.3.** Mundësinë e huadhënësit, shtetasit N. Q., për të krijuar me burime të ligjshme shumën prej 23.000 USD, për të cilën Komisioneri Publik pretendon se konstatohen deklaramë kontradiktore, pasi sikundër ka rezultuar nga hetimi administrativ, në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit, konstatohet vetëm transferta e shumës 15.296 euro, në datë 5.10.2005, me urdhërues G. Zh., ndërkohë që kontrata e huasë, e datës 12.09.2005, e nënshkruar ndërmjet bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit N. Q. referon se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka marrë shumën e dhënë hua prej 23.000 USD, ndërsa në Deklaratën Noteriale të datës 23.08.2019<sup>46</sup>, huadhënësi N. Q. deklaroi se ka transferuar shumën e huasë në datën 10.05.2005. Komisioneri Publik pretendoi gjithashtu se pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me burimin e depozitimit *cash* në datën 10.08.2005, në shumën prej 22.600 USD, mbetën në nivel deklarativ dhe, si rrjedhojë, sipas tij, duket se shuma prej 22.600 USD ka si burim fonde të vetë subjektit të rivlerësimit.

**81.4.** Shlyerjen e huasë prej 23.000 USD, si detyrim të mbetur ndaj N. Q., në shumën 11.500 USD, të deklaruar në deklarin para fillimit të detyrës të vitit 2009, për efekt të së cilës subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPPV-në e vitit 2010, pakësimin e depozitës në shumën 7000 euro, ndërkohë që ka rezultuar që kjo shumë është krijuar nga kreditimi i shumës prej 9.362 eurosh, në maj të vitit 2009, nga E. Q. (i biri i N. Q.) me përshkrimin “Dhënie huaje”, e cila nuk rezultoi të jetë deklaruar si detyrim në deklarin e vitit 2009. Lidhur me sa më sipër, në vlerësimin e ankuesit, për sa kohë gjatë hetimit administrativ nuk u provuan burimet e ligjshme të E. Q. për të dhënë këtë hua, rrjedhimisht, për efekt të këtij procesi, edhe shuma e tërhequr në vitin 2010 nga pakësimi i

---

<sup>46</sup> Viti konstatohet të jetë një lapsus i Komisionerit Publik pasi kjo deklarin është dhënë në datën 23.08.2018.

depozitës bankare, me burim të ardhurat e E. Q., nuk mund të konsiderohet si burim për shlyerjen e huasë së marrë nga z. N. Q..

**81.5.** Deklarimet e subjektit të rivlerësimit, sipas Komisionerit Publik, vlerësohen kontradiktore edhe sa i takon dhurimit të shumës prej 9.000 eurosh nga babai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, shumë që ka rezultuar e transferuar nga B. F., e padeklaruar më parë nga subjekti dhe për të cilën vetëm në përfundim të hetimit administrativ pretendoi se vinte nga të ardhurat e babait të bashkëshortes.

**81.6.** Në përfundim, lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament” në rrugën “{\*\*\*}”, Komisioneri Publik vlerësoi se analiza financiare rezultoi me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, si dhe personave të tjerë të lidhur me të, për të mbuluar shpenzimet, kursimet dhe investimet në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, duke kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

➤ *Lidhur me krijimin e dy pasurive të llojit “garazh” në të njëjtën ndërtesë me apartamentin e banimit në rrugën “{\*\*\*}”, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me këto dy pasuri të paluajtshme, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, si dhe rezultoi me një diferencë negative të konsiderueshme në raport edhe me gjetjet e tjera të kontrollit të pasurisë, përtej asaj të konstatuar nga Komisioni në vlerën e plotë të blerjes së tyre.*

**82.** Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar si tërësisht të pabazuara, në kundërshtim me provat e administruara gjatë hetimit, si dhe jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, shkaqet e ngritura në ankim nga Komisioneri Publik për këto dy pasuri të paluajtshme. Konkretisht:

**82.1.** Subjekti i rivlerësimit prapësoi gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj se për këtë pasuri ka paguar 6.341.775 lekë te shtetasi S. T., aq sa përcaktohet në kontratën e shitjes. Më konkretisht, ai deklaroi se për apartamentin, ka paguar 51.800 euro te pronari i truallit dhe 10.000 euro te ndërtuesi, përveç kësaj ai ka paguar edhe 8000 euro për një pjesë të mobilimit. Këto pagesa, sipas tij, ndryshe nga ç’pretendon Komisioneri Publik, *duhet të përlllogariten në analizë financiare në shumën 6.341.775 lekë, të paguar në vitin 2008, ndërsa vlera prej 18.000 eurosh, e shpenzuar për punime sipas porosisë së bashkëshortes së subjektit dhe një pjesë mobilim, paguar te shoqëria, në shumën 18.000 euro.*

**82.2.** Lidhur me mundësinë e dhuruesit, z. P. Gj., për të krijuar me burime të ligjshme shumën e deklaruar të dhuruar, prej 40.000 eurosh, subjekti i rivlerësimit pretendoi se për efekt të këtij procesi, duhet të merren në konsideratë të gjitha të ardhurat nga pensioni i tij për shkak se ky shtetas ka emigruar në Greqi përpara vitit 2003 dhe shpenzimet jetike janë mbuluar në Greqi. *Gjatë qëndrimit në Greqi, ai ka pasur mundësi të kursejë të ardhura të paktën në vlerën e*

*shpenzimeve jetike, për këtë arsye vlera 40.000 euro duhet të përllogaritet në analizën financiare.*

**82.3.** Lidhur me shumën e shpenzuar për mobilimin apo punimet shitesë në vitin 2009 (pra, si pjesë e shumës 18.000 deklaruar shoqërisë), subjekti pretendoi se bashkëshortes i janë dhuruar 9.000 euro nga babai i saj, shumë që rezulton e transferuar nga shtetasi B. F. Subjekti pranoi mosdeklarimin e këtij dhurimi me justifikimin se ka shërbyer për mobilim dhe, si i tillë, nuk ka qenë i deklaruar në DPV-në e vitit 2009 (për këtë arsye është harruar<sup>47</sup>), por pretendoi gjithashtu se kjo pasaktësi e subjektit, në kushtet kur ky dhurim provohet me dokumentacion bankar dhe dhuruesi ka burime financiare të ligjshme, nuk mund të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore.

**82.4.** Lidhur me huanë në shumën 23.000 USD për blerje shtëpie sipas kontratës nr. {\*\*\*/{\*\*\*}}, datë 12.09.2005, me afat 10 vjet, duke shlyer nga 2.300 USD në vit, subjekti i rivlerësimit prapësoi se ndryshe nga sa pretenduar nga Komisioneri Publik, lidhur me këtë hua nuk konstatohen deklarime kontradiktore të subjektit të rivlerësimit dhe, në këto kushte, kjo hua duhet të përllogaritet në analizën financiare. Ashtu sikundër ka rezultuar nga hetimi administrativ, në llogarinë bankare të subjektit provohet transferta e shumës 15.296 euro në datën 05.10.2005, me urdhërues G. Zh.. Kontrata e huasë e datës 12.9.2005, nënshkruar ndërmjet bashkëshortes së subjektit dhe shtetasit N. Q., referon se bashkëshortja e subjektit ka marrë shumën e dhënë hua prej 23.000 USD.

**82.5.** Lidhur me depozitimin nga bashkëshortja e subjektit të shumës 22.600 USD, të depozituar cash në llogarinë e saj bankare më datë 10.08.2005, subjekti rikonfirmoi sa parashtruar lidhur me këtë depozitim edhe në prapësimet e tij ndaj shkakut të ngritur në ankim lidhur me vlerësimin e pasurisë “apartament banimi” në rrugën “{\*\*\*}”, qëndrim ky i njëjtë edhe me qëndrimin e mbajtur lidhur me këtë çështje gjatë hetimit administrativ në Komision.

**82.6.** Në lidhje me shlyerjen e huasë prej 23.000 USD, subjekti i rivlerësimit prapësoi se – ndryshe nga sa pretendon ankuesi, se gjatë hetimit administrativ nuk u provuan burimet e ligjshme të E. Q. për të dhënë huanë në shumën 9.962 euro, rrjedhimisht dhe tërheqja e depozitës në vitin 2010, e krijuar nga shuma prej 9.962 eurosh, nuk mund të konsiderohet si burim për shlyerjen e huasë së marrë N. Q. nga bashkëshortja e subjektit – ai ka deklaruar dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues se shuma e marrë nga E. Q. ka si burim të ardhurat e shtetasit G. Zh.. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se gjatë hetimit administrativ janë administruar prova që tregojnë transfertën e parave nga G. Zh. tek E. Q.. Ndërsa, sa i takon justifikimit të burimit të huasë së dhënë nga shtetasi E. Q. apo N. Q., subjekti pretendoi se ka paraqitur dokumentacion bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting* lidhur me të ardhurat e shtetasit G. Zh.. Konkluzioni i ankuesit në lidhje me shlyerjen e huasë, sipas subjektit të rivlerësimit, është i pabazuar.

---

<sup>47</sup> Sepse subjekti, përveç kësaj shume, ka deklaruar edhe 10.000 euro shpenzime të tjera në vitet 2010 dhe 2011 për këtë apartament.

83. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues konstatoi fillimisht se, duke qenë se apartamenti në rrugën “{\*\*\*}” nuk është pasuri e deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, vlerësimi lidhur me këtë pasuri, nuk mund të çmohet në kuptim të saktësisë dhe mjafueshmërisë së deklaratimit sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, por rezultatet e këtij vlerësimi do të çmohen në kuadër të parashikimeve të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dhe efektet e tij do të shtrihen në analizën financiare të vitit në të cilin është krijuar kjo pasuri, si dhe në vlerësimin e pasurisë së paluajtshme të llojit apartament në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, të blerë në vitin 2015, për të cilin të ardhurat nga shitja e apartamentit në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, janë deklaruar si burim krijimi.
84. Nga verifikimi i pretendimeve të ankuesit lidhur me shkakun e ngritur në ankim për kundërshtimin si të pabazuar të konkluzionit të Komisionit lidhur me këtë pasuri, të cilat adresohen në drejtim të mospërmbysjes së barrës së provës së kaluar nga Komisioni, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, vëren se, në përfundim të hetimit të kryer, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të paraqitur shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të mëposhtme:
- *Duket se subjekti ka pasur pamundësi financiare për të kryer pagesat për apartamentin në vlerën (-) 4.065.392 lekë.*
  - *Duket se shuma totale për burimet e krijimit të apartamentit në rrugën “{\*\*\*}”, të deklaruar prej bashkëshortes së subjektit, është në vlerën totale 56.983 euro, ndërsa vlera e apartamentit është në shumën 61.800 euro.*
  - *Duket se subjekti i rivlerësimit ka pamundësi në krijimin e pasurisë garazh me të ardhura të ligjshme në vlerën totale të saj prej (-)14.000 eurosh ose rreth (-)1.920.380 lekësh.*
85. Këto gjetje, për të cilat Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, i ka mbështetur në konstatimet e mëposhtme.
- Lidhur me apartamentin në rrugën “{\*\*\*}”:
    - *Komisioni do të përfshijë në llogaritjet e tij vlerën totale prej 61.800 eurosh, sipas parashikimeve të kontratës së porosisë, duke i shtuar çmimit të kontratës së porosisë vlerën 18.000 euro për punimet shtesë, pasi nuk u provua gjatë hetimit se diferenca e çmimit vjen nga kryerja e punimeve shtesë nga bashkëshortja e subjektit dhe se shoqëria ka shlyer shtetasin S. T. për diferencën e vlerës prej 10.000 eurosh. Pra, vlera totale e apartamentit në analizën e Komisionit është përfshirë në shumën 79.800 euro.*
    - *Duke iu referuar shpjegimeve të subjektit, duket e paqartë arsyeja e transferimit të shumës 15.297 euro nga z. G. Zh. në llogarinë e subjektit në Procredit Bank në datën 05.10.2005, e cila është përdorur si burim për pagesat e apartamentit në rrugën “{\*\*\*}”, kur bashkëshortja e subjektit në datën 22.08.2005 (vetëm 1,5 muaj përpara) ka pasur likuiditete të disponueshme në vlerën 22.600 USD, por të cilat ia ka dhënë shtetasit A. Sh. dhe znj. D. Sh., për nevojat e tyre.*
    - *Nga analiza financiare duket se z. P. Gj. ka pasur mundësi të kursejë me të ardhura të ligjshme vlerën 31.501 euro nga viti 2003 - shkurt 2008. Pra, me dokumentacionin e përcjellë, rezulton se*

ka pamundësi në vlerën 8.499 euro, ose rreth 1.046.938 lekë, për të dhënë me të ardhura të ligjshme vlerën 40.000 euro, bashkëshortes së subjektit.

- *Duket e paqartë arsyeja e marrjes së huasë prej 23.000 USD nga bashkëshortja dhe subjekti në vitin 2005, kur nga hetimi rezultoi se kontrata e shitjes me rezervë për apartamentin e ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, është lidhur në vitin 2008 dhe në këtë vit ka filluar edhe shlyerja e kësaj huaje.*

86. Në vlerësim të akteve të fashikullit të çështjes, si dhe pas shqyrtimit të prapësimeve të subjektit të rivlerësimit të dorëzuar në Komision ndaj rezultateve të hetimit dhe barrës së provës që i kishte kaluar Komisioni lidhur me gjetjet e sipërcituara, në konsideratë dhe të qëndrimit të mbajtur në Kolegj, i cili konstatohet të jetë i njëjtë me qëndrimin e mbajtur në Komision, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.

- *Lidhur me vlerën totale të paguar nga subjekti i rivlerësimit për apartamentin objekt kontrolli:*

86.1. Trupi gjykues konstaton se në prapësimet e tij ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit është shprehur: [...] *Duke qenë se këto punime, në vlerën 10.000 euro, do të kryheshin nga shoqëria për llogari të porositësit të ri D. Sh. (sipas materialit të përzgjedhur dhe orientimeve të porositësit), pranohet përmbushja e detyrimit në këtë vlerë ndaj pronarit të truallit S. T., nga shoqëria. Pra, meqenëse një pjesë e punimeve do të kryheshin prej nesh me cilësi më të mirë, kostoja respektive e këtyre punimeve apo vlera e këtyre punimeve që ishte marrë si detyrim nga shoqëria fillimisht ndaj pronarit të truallit do të paguhej prej nesh te shoqëria, ndërsa shoqëria do t'i njihte si detyrim shtetasit S. T., vlerën 10.000 euro. Për këtë arsye, ashtu siç kam shpjeguar gjatë hetimit administrativ, vlera e paguar te shtetasi S. T. nuk është 61.800 euro ~ 7.612.679 lekë, por 6.341.775 lekë, ashtu siç është përcaktuar në kontratën e shitjes me shtetasin S. T., pra 10.000 euro më pak. [...] ne jemi dakordësuar me shoqërinë e ndërtimit që të kryheshin disa punime dhe një pjesë mobilimi, sipas përzgjedhjes sonë. Nëse këto punime do të kryheshin me cilësinë e zakonshme që shoqëria kishte marrë përsipër, atëherë ato do të vlerësoheshin në shumën 10.000 euro, të cilën e zbritën nga vlera e kontratës së sipërmarrjes (prandaj kontrata e shitjes me z. S. T. ka vlerë më të vogël; vlera respektive, 10.000 euro, u njoh si detyrim i shoqërisë ndaj tij) në momentin që u realizuan punimet së bashku me një pjesë të mobilimit, vlera e këtyre punimeve me cilësi të përmirësuar shkoi në vlerën 18.000 euro. Prandaj, në analizën financiare, vlera e paguar shtetasit S. T. duhet të përlllogaritet e barabartë me 6.341.775 lekë, ndërsa vlera për punime shtesë dhe një pjesë e mobilimit, paguar te shoqëria, në shumën 18.000 euro.*

86.2. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në Komision një shkresë të thjeshtë të titulluar “Deklaratë”, të lëshuar nga administratori i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, z. Xh. N., më datë 23.04.2024, i cili shprehet se: *Janë kryer punime të brendshme të përshkruara në deklaratën e datës 07.10.2009, në vlerën totale 2.480.940 lekë, sipas mandatpagesës së datës 13.10.2009, me vlerë totale 18.000 euro. Në këtë vlerë përfshihen punimet shtesë në vlerën 10.000 euro dhe vlera 8000 euro për mobilim. Kostoja e punimeve shtesë në vlerën 10.000 euro, të kryera nga porositësi D. Sh., i është kthyer pronarit të truallit, z. S. T., nga shoqëria*

“{\*\*\*}” ShPK me mandatin nr. {\*\*\*}, datë 13.01.2010. Bashkëlidhur mandati nr. {\*\*\*}, datë 13.01.2010.

**86.3.** Nga shqyrtimi i kësaj mandatpagese, të dorëzuar bashkëlidhur prapësimeve, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë faktin se vlera prej 10.000 eurosh, e përcaktuar në këtë mandatpagesë si *shumë e cila është brenda vlerës së kontratës nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 04.06.2008, të porositur nga znj. D. Sh.*, t’i jetë paguar z. S. T. sikundër urdhërohet, pasi nuk ka asnjë shenjë pranimi nga përfituesi i pretenduar i kësaj shume. Asnjë provë apo e dhënë tjetër në drejtim të të provuarit të këtij fakti nuk është dorëzuar nga ana e subjektit të rivlerësimit.

**86.4.** Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit se në apartamentin e tyre në rrugën “{\*\*\*}”, të blerë nga z. S. T., kanë kryer punime shtesë të një cilësie më të mirë, sipas nevojës dhe përzgjedhjes së tyre, të cilat kanë rezultuar të kenë pasur një kosto financiare të vlerësuar në shumën prej 10.000 eurosh, po aq sa pretendohet të ketë qenë edhe kostoja e punimeve të marra përsipër nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK në kuadër të sipërmarrjes për ndërtimin e objektit në tokën në bashkëpronësi të z. T., punime këto të cilësuar nga subjekti si *të cilësisë së zakonshme*, vlerësohen nga trupi gjykues si të paqarta/pakuptimta. Trupi gjykues vëren se, referuar pretendimeve të shoqërisë sipërmarrëse dhe subjektit të rivlerësimit, nëse punimet shtesë të urdhëruara nga znj. D. Sh. kanë pasur një kosto totale prej 18.000 eurosh, nga e cila shuma prej 8.000 eurosh konstatohet t’i atribuohet mobilimit të pjesshëm të apartamentit, është e paqartë përse shuma e mbetur prej 10.000 eurosh, e cila ishte e përfshirë në çmimin e apartamentit, duhet t’i paguhej të njëjtit sipërmarrës (kur ky këtë vlerë punimesh e kishte detyrim kontraktual për ta kryer) dhe shoqëria sipërmarrëse t’ia kthente këtë vlerë shitësit të apartamentit, z. T.. Kjo pagesë pranë shoqërisë sipërmarrëse nga blerësja do të kishte kuptim në rastin kur porosia për kryerjen e këtyre punimeve të brendshme, sipas dëshirës së subjektit të rivlerësimit, do të vinte në një stad të avancuar të ndërtimit të apartamentit të blerë, ku kostoja e punimeve të kërkuara nga znj. D. Sh. do të rezultonte *de facto* një kosto shtesë, përtej vlerës së shitblerjes së apartamentit. Trupi gjykues konstatoi gjithashtu se kjo marrëdhënie e pretenduar trepalëshe nuk u provua të jetë materializuar në ndonjë akt shkresor ku të tria palët (shitësi – z. S. T., blerësja – znj. D. Sh. dhe ndërtuesi i pallatit – shoqëria “{\*\*\*}” ShPK) të dakordësonin mbi këtë mënyrë të operuari, e cila shoqërohej me qarkullim vlerash të konsiderueshme monetare.

**86.5.** Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e sa konstatuar nga Komisioni në rezultatet e hetimit në lidhje me vlerën e pasurisë, e cila edhe në eventualitetin e ndryshimit të mëposhëm të tij do të duhej të gjente pasqyrim nëpërmjet një amendimi në kontratën e lidhur për këtë qëllim, konkretisht në kontratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 04.06.2008, të lidhur para noteres V. S., e cila konstatohet të jetë një kontratë shitblerjeje me rezervë për ruajtjen e pronësisë mbi apartamentin e blerë, deri në shlyerjen totale të çmimit të përcaktuar në këtë kontratë. Nga ana tjetër, rezultoi se akti i cili ka shërbyer për Komisionin në drejtim të bindjes së këtij të fundit mbi

çmimin e shitblerjes së apartamentit objekt kontrolli, është një kontratë e mëpasshme noteriale e shitjes së pasurisë së paluajtshme, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 27.07.2012, e lidhur para noteres A. M., në të cilën thuhet se: *Shitësi deklaron se pronën sa më sipër ia shet blerësit kundrejt shumës 6.341.775 lekë. Kjo vlerë është likuiduar nga ana e blerësit në favor të shitësve jashtë kësaj zyre, kesh dhe nëpërmjet bankës, sipas kontratës së sipërmarrjes.* Ndërkohë, gjatë hetimit nuk rezultoi ndonjë kontratë sipërmarrjeje e lidhur as mes z. S. T. dhe znj. D. Sh., as mes kësaj të fundit dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK.

87. Në vijim të sa më sipër, nga vlerësimi i pasurisë apartament në rrugën “{\*\*\*}”, trupi gjykues gjeti të drejtë dhe të bazuar në faktet e rezultuara gjatë gjykimit, pretendimin e ankuesit për përlllogaritjen e investimit të kryer nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëshortja e tij, znj. D. Sh., në shumën totale prej 79.800 eurosh. Kjo shumë u përlllogarit nga trupi gjykues si shumatore e çmimit të kontratës së shitjes me rezervë të pasurisë së paluajtshme “apartament banimi” të lidhur në vitin 2008<sup>48</sup> prej 61.800 eurosh dhe investimit të kryer në këtë pasuri (punime shtesë dhe mobilim) në shumën 18.000 euro, sipas mandatpagesës së datës 13.10.2009, në favor të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK.

▪ Lidhur me analizën e burimeve të krijimit të pasurisë “apartament” në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë:

88. Në shqyrtim të pretendimeve mbi verifikimin e mundësisë së dhuruesit, shtetasit P. Gj., për të krijuar me burime të ligjshme shumën e deklaruar si të dhuruar prej 40.000 eurosh, trupi gjykues, pasi kontrolloi analizën e kryer nga Komisioni nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, si dhe shqyrtoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi se bashkëlidhur informacionit të marrë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Tiranë, nëpërmjet vërtetimit nr. {\*\*\*} prot., datë 12.01.2021, rezultoi të jetë dërguar nga ky institucion edhe tabela e përlllogaritjes së pensionit për shtetasin P. Gj., ku janë pasqyruar në mënyrë kronologjike shumat e pensioneve të përfituara për çdo muaj dhe vit, për periudhën 01.07.1995 - 01.04.2020. Referuar këtyre të dhënave, ndryshe nga Komisioni, rezultoi se të ardhurat e përfituara nga ky shtetas nga pensioni i pleqërisë për periudhën 1995 - 2002 janë në shumën 494.418 lekë<sup>49</sup> dhe jo sa përlllogaritur nga Komisioni, në shumën prej 2.257.399 lekësh<sup>50</sup>. Rezultati i Komisionit mbi përlllogaritjet e pensioneve për periudhën 1995-2002, në shumën prej 2.257.399 lekësh, dukshëm është një rezultat i gabuar vlerësuar në raport me masën e ulët të përfitimit mujor nga pensioni për periudhën objekt vlerësimi, si edhe në raport me shumën e përfituar për periudhën e përfitimit 1 korrik 1995 – 1 prill 2020, të përcaktuar në shumën totale prej 3.594.951 lekësh. Nga shuma e pensioneve të përfituara për këtë periudhë nga z. P. Gj., rezulton se pas zbritjes së shpenzimeve të jetesës për të njëjtën periudhë, në shumën 472.260 lekësh<sup>51</sup>, mundësia e kursimit për periudhën 1995-2002, paraqitet me vetëm 22.104

<sup>48</sup> Kontrata e shitjes me rezervë të pasurisë së paluajtshme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 04.06.2008.

<sup>49</sup> Shuma e konvertuar në 3.735 euro me kursin mesatar vjetor sipas Bankës së Shqipërisë (1 euro = 132,36 lekë).

<sup>50</sup> Konvertuar në 17.055 euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë (1 euro = 132,36 lekë).

<sup>51</sup> Shpenzimet jetike u përlllogaritën në masën 66% deri në fund të vitit 1999 dhe, sipas të dhënave të INSTAT-it për periudhën 2000-2002, në shumën 472.260 lekë të konvertuara në shumën 3.568 euro.

lekë<sup>52</sup>, shumë kjo e papërfillshme. Analiza e Komisionit për vitet në vijim, pasi u verifikua nga trupi gjykues, rezultoi pa probleme. Për rrjedhojë, të ardhurat nga pensioni në Shqipëri për periudhën korrik 1995 – shkurt 2008, përllogariten në shumën totale prej 8.425 eurosh.

89. Në këto kushte, në lidhje me burimin e deklaruar *dhurim në shumën prej 40.000 eurosh*, në favor të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. D. Sh., nga babai i saj P. Gj., pas korigjimit të zërit “Të ardhurat nga pensioni në Shqipëri, konvertuar në euro” në tabelën nr. 8 të vendimit të Komisionit, rezultoi se nga vlerësimi i burimeve të ligjshme të dhuruesit, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, vetëm shuma prej 36.358<sup>53</sup> eurosh u gjet e justifikuar me burime të ligjshme dhe, rrjedhimisht, u përfshi si burim i ligjshëm për krijimin e pasurisë objekt vlerësimi<sup>54</sup>.
90. Në lidhje me burimin e deklaruar *hua në shumën prej 23.000 USD*, sipas kontratës së lidhur nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. D. Sh., dhe z. N. Q. në vitin 2005<sup>55</sup>, në vijim edhe të analizës së paraqitur më sipër në këtë vendim lidhur me trajtimin e kësaj huaje, trupi gjykues, pasi kontrolloi analizën e Komisionit, vlerësoi të drejtë konkluzionin e këtij të fundit për konsiderimin si burim të ligjshëm vetëm të shumës prej 15.296 eurosh, të kaluar në favor të subjektit të rivlerësimit sipas transfertës bankare të datës 05.10.2005, me dërgues z. G. Zh., burimet e ligjshme të të cilit rezultuan të jenë verifikuar në përputhje me parashikimet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
91. Në shqyrtimin e pretendimit të ankuesit lidhur me moskonsiderimin e shlyerjes nga subjekti i rivlerësimit të pjesës së mbetur të huasë ndaj N. Q. me të ardhura të ligjshme, me pretendimin se shumata e rezultuara nga pakësimi i depozitës bankare të subjektit, të krijuar me burim huanë e marrë nga E. Q., nuk mund të vlerësohen si burim i ligjshëm për shlyerjen e huasë ndaj N. Q., sa kohë nuk u provuan burimet e ligjshme të huadhënësit E. Q. – trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.

91.1. Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2009, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar se detyrimi i mbetur ndaj N. Q., lidhur me huanë e marrë prej saj në vitin 2005, në shumën e 23.000 USD, është në shumën 11.500 USD, ndërsa në deklaratën periodike të vitit 2010, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: *Nga të ardhurat e pagës së mësipërme, janë kursyer një shumë prej 500.000 lekësh, ndërsa një shumë prej 200.000 lekësh dhe depozita e bashkëshortit prej 7.000 eurosh kanë shërbyer për shlyerjen e huasë së mbetur në shumën 11.500 USD.*

---

<sup>52</sup> Konvertuar në shumën 167 euro sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë [1 euro = 132,36 lekë (3.735 euro - 3.568 euro = 167 euro)].

<sup>53</sup> Ndryshe nga sa përllogaritur nga Komisioni në shumën 43.728 euro.

<sup>54</sup> Shuma 167 euro për periudhën 1995-2002, shuma 1.788 euro në vitin 2003, shuma 7.391 euro në vitin 2004, shuma 7.848 euro në vitin 2005, shuma 9.532 euro në vitin 2006, shuma 7.892 euro në vitin 2007, shuma 1.740 euro në periudhën 01.01.2008 - shkurt 2008 (total shuma 36.358 euro).

<sup>55</sup> Kontratë huaje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 12.09.2005.

91.2. Nga verifikimi i llogarisë së subjektit pranë Raiffeisen Bank, rezultoi se shuma prej 9.962 eurosh është kredituar në maj të vitit 2009, nga E. Q., me përshkrimin “Dhënie huaje”, shumë kjo e cila ka kaluar nga subjekti i rivlerësimit në “depozitë me afat” në të njëjtën bankë, deri në datën 24.09.2010, kur ajo është mbyllur si pasojë e pakësimit të vlerës totale të saj. Likuiditetet e depozituara si më sipër, janë tërhequr përkatësisht 2.341 euro në datën 25.11.2009, 1000 euro në datën 14.12.2009 dhe pjesa e mbetur prej 7.000 eurosh është tërhequr si vijon: 1000 euro në datën 14.06.2010, 1.000 euro në datën 02.07.2010 dhe 5.000 euro në datën 24.09.2010.

91.3. Trupi gjykues konstatoi se në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në lidhje me shlyerjen e huasë prej 23.000 USD, se huaja e marrë nga shtetasi E. Q. në vlerën 9.962 euro, është marrë për nevoja familjare në muajin maj 2009, nëpërmjet bankës Intesa San Paolo. Kjo hua, sipas tij, i është kthyer *cash* shtetasit E. Q. në muajin shtator 2009, fakt i konfirmuar edhe me deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 27.09.2016, nga shtetasi E. Q.. Nga biseda me shtetasin E. Q., më është konfirmuar se si burim i dhënies së huasë, kanë qenë të ardhurat e shtetasit G. Zh. dhe familjarëve të tij në Mbretërinë e Bashkuar. Subjekti pretendoi se është bërë subjekt deklarimi më datë 10.12.2009, dhe deri në këtë datë, huaja e marrë nga shtetasi E. Q., në vlerën 9.962 euro, ka qenë e likuiduar dhe, duke qenë se nuk ekzistonte më si detyrim, ka menduar se nuk duhej deklaruar.

91.4. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues e gjen të nevojshëm verifikimin e burimeve të ligjshme të huadhënësit E. Q. për të justifikuar shumën e dhënë hua si më sipër pretenduar, në kuptim të parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, me qëllim arritjen në një konkluzion mbi pretendimin e ankuesit në drejtim të burimeve të përdorura nga subjekti i rivlerësimit në shlyerjen e pjesës së mbetur të huasë prej 11.500 USD, të marrë nga bashkëshortja e tij në vitin 2005 nga N. Q.. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit se të ardhurat e dhëna hua nga E. Q. ishin të ardhura të G. Zh., u vlerësuan nga trupi gjykues të paprovuara edhe pas shqyrtimit të çështjes në Kolegj.

91.5. Në vijim të sa më sipër, nga verifikimi i kryer në Kolegj lëvizjeve bankare të shtetasit E. Q., u konstatua që për periudhën janar 2007 – maj 2009, ky shtetas ka përfutur të ardhura nga paga nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, në shumën 1.205.974 lekë. Pas përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës sipas standardit të Kolegjit, të bazuar në të dhënat e INSTAT-it për këtë periudhë, në shumën 429.513 lekë, trupi gjykues konstatoi se shtetasi E. Q. mund të justifikonte me burime të ligjshme huanë e dhënë për një vlerë prej 776.461 lekësh ose 5.660 euro dhe, rrjedhimisht tërheqja e depozitës së krijuar nga subjekti në vitin 2010, në shumën prej 7.000 eurosh, me të ardhurat e kësaj huaje, u konsiderua si burim për shlyerjen e huasë së marrë nga N. Q. në vitin 2010 vetëm në shumën e 776.461 lekëve<sup>56</sup>.

---

<sup>56</sup> U përlllogarit mungesë burimesh në vlerën 195.209 lekë (971.670 lekë - 776.461 lekë = 195.209 lekë).

91.6. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj për vitin 2010, mbi bazën e të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera, subjekti i rivlerësimit rezultoi me balancë pozitive, për rrjedhojë vlerësohet se ai ka pasur mundësi financiare për shlyerjen e detyrimit në shumën 11.500 USD ndaj N.Q.(konvertuar në shumën 1.206.925 lekë<sup>57</sup>).

92. Në lidhje me pretendimin e ankuesit se deklarimet e subjektit të rivlerësimit vlerësohen kontradiktore edhe sa i takon dhurimit të shumës prej 9000 eurosh nga babai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, shumë që ka rezultuar e transferuar nga B. F., e padeklaruar më parë nga subjekti dhe për të cilën, vetëm në përfundim të hetimit administrativ, pretendoi se vinte nga të ardhurat e babait të bashkëshortes, trupi gjykues konstatoi se Komisioni lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, ka konkluduar se: *në lidhje me vlerën e transfertës në llogarinë e subjektit pranë Alfa Bank, në datën 5 mars 2009, nga dërguesi B. F., është arritur elementi i provueshmërisë, por pavarësisht kësaj, Komisioni ka çmuar se kjo shumë nuk do të përfshihet si burim për krijimin e apartamentit objekt kontrolli, pasi subjekti nuk e ka deklaruar këtë vlerë as në deklaratën e pasurisë vetting dhe as në deklaratën periodike të vitit 2009.*
93. Ndodhur në këto kushte dhe në mungesë të kundërshtimit në ankim të konkluzionit të mësipërm të Komisionit, pretendimet e subjektit të rivlerësimit në Kolegj për përfshirjen në mesin e burimeve financiare të ligjshme edhe të një shume prej 9000 eurosh të pretenduar si dhurim nga P. Gj., por të kaluar në llogarinë bankare të subjektit nëpërmjet një transferte në Alfa Bank nga shtetasi B. F., trupi gjykues i gjeti të pabazuara duke konfirmuar si të drejtë konkluzionin e Komisionit dhe qëndrimin e ankuesit për mospërfshirjen e kësaj shume si burim të ligjshëm për mbulimin e investimit në këtë pasuri.
94. Në përfundim të analizës për vlerësimin e krijimit të pasurisë apartament në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, trupi gjykues, bazuar në konkluzionet e mësipërme lidhur me vlerësimin e burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, arriti në konkluzionin se për investimin e kryer në shumën totale prej 79.800 eurosh, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, në shumën e 28.146 eurove<sup>58</sup>.
95. Në lidhje me pretendimin e ankuesit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me krijimin e pasurisë së paluajtshme “garazh me 2 vendparkime (nr. {\*\*\*}, {\*\*\*})” me sipërfaqe 35 m<sup>2</sup>, në të njëjtin pallat me apartamentin e porositur në rrugën “{\*\*\*}”, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke rezultuar me një diferencë negative të konsiderueshme në raport edhe me gjetjet e tjera të kontrollit të pasurisë, trupi gjykues vëren se, ndonëse ankuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë të kësaj pasurie,

---

<sup>57</sup> Komisioni ka përlllogaritur shlyerjen e huasë prej 11.500 USD në shumën 1.596.315 lekë në vitin 2010, mirëpo referuar kursit të këmbimit sipas Bakës së Shqipërisë, në këtë vit përlllogaritet shuma e shlyerjes prej 1.206.925 lekësh.

<sup>58</sup> Vlera e apartamentit në shumën 79.800 euro – hua nga G. Zh. në shumën prej 15.296 eurosh – dhurimi i justifikuar në shumën prej 36.358 eurosh nga P. Gj. = mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 28.146 euro.

nuk paraqet asnjë shkak ligjor mbi bazën e të cilit të mbështetë pretendimin në lidhje me pasaktësi në deklarin e saj.

96. Pavarësisht sa më sipër, pasi kontrolloi deklarin e subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë pasuri në deklaratën e pasurisë *vetting*, duke e vlerësuar këtë deklarin në raport me deklarin e kryer në deklaratën periodike të vitit 2009, si dhe me përmbajtjen e kontratës së sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 13.11.2009, me anë të së cilës është porositur pasuria objekt kontrolli, trupi gjykues nuk konstatoi ndonjë problematikë në lidhje me komponentin e saktësisë dhe plotësisë së deklarin të kryer nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të detyrimit kushtetues të parashikuar nga neni D i Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, pretendimi i ankuesit për deklarin të pasaktë të kësaj pasurie, u gjet i pabazuar në fakte.
97. Sa i takon pretendimit të ankuesit për mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie të porositur në vitin 2009, me vlerë 14.000 euro, të paguar në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, sipas parashikimit kontraktual dhe me burim krijimi të *ardhurat nga puna ndër vite së bashku me bashkëshorten*, trupi gjykues, pasi kontrolloi analizën e kryer nga Komisioni<sup>59</sup>, sipas së cilës: *subjekti i rivlerësimit ka rezultuar në pamundësi të kryerjes së blerjes të tyre me të ardhura të ligjshme në shumën (-) 1.677.880 lekë (12.232 euro)*, konstatoi se ky rezultat është rrjedhojë e një analize ku vlerat e të ardhurave dhe pasurive të përfshira janë përlllogaritur në mënyrë të gabuar nga Komisioni për arsyet e trajtuara në këtë vendim lidhur me kontrollin e burimeve financiare për krijimin e pasurive të subjektit të rivlerësimit.
98. Në këto kushte, pas korrigjimit në Kolegj të analizës financiare të Komisionit për pasurinë “garazh me dy poste parkimi”, bazuar në konkluzionet e arritura nga trupi gjykues më sipër në vendim, mungesa e burimeve të ligjshme e konstatuar nga Komisioni, në shumën (-)1.677.880 lekë (12.232 euro), do të rritej ndjeshëm duke tejkalluar vlerën e paguar për porositjen e tyre prej 14.000 eurosh.
99. Për rrjedhojë, trupi gjykues arriti në përfundimin se pretendimi i ankuesit për mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie të paluajtshme në vitin 2009, në shumën e plotë të blerjes së saj prej 14.000 eurosh, u gjet i bazuar në fakte e në ligj, dhe subjekti i rivlerësimit në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme sipas nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 edhe për këtë pasuri.
100. *Lidhur me shkakun e ankimit për deklarin të pamjaftueshëm të subjektit të rivlerësimit lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament me sipërfaqe 96,5 m<sup>2</sup>”, me vendndodhje në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.*
101. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, lidhur me vlerësimin e kësaj pasurie ka konkluduar se: *për pasurinë apartament të ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, pas përcjelljes së shpjegimeve dhe gjatë seancës dëgjimore, subjekti arriti të përcjellë prova, nga të cilat Komisioni vlerësoi se*

---

<sup>59</sup> Shih tabelën nr. 10 në faqen 35 të vendimit të Komisionit.

*pamundësia financiare është (-)10.139 euro ose (-) 1.420.557 lekë<sup>60</sup>. Këtë konkluzion, Komisioni duket ta ketë bazuar në arsyetimin se: [...] Komisioni çmon se fakti i depozitimit cash nga shtetasi E. Q. në vitin 2010, të vlerës 70.000 euro në llogarinë e tij në BKT, gati 6 vite para se të merrej huaja, duke u transferuar me bankë në llogarinë e subjektit në vitin 2016 dhe kthimi i kësaj shume nga subjekti përsëri me bankë, nga të ardhurat e shitjes së apartamentit në rr. “{\*\*\*}”, përbëjnë element transparence dhe të provueshmërisë në kryerjen e këtij transaksioni. Në përfundim, Komisioni vlerëson se vlera 5.000 USD në vitin 2015 (për të cilën u provua burimi i ligjshëm nga analiza financiare) dhe shuma 40.000 euro në vitin 2016 duhet të përfshihen si burim krijimi për blerjen e apartamentit në rr. “{\*\*\*}”, Tiranë dhe duhet të përfshihen në analizën e Komisionit. [...] Vlera e kursimeve cash, e përfshirë në analizën e Komisionit të përditësuar si burim për këstin e parë të apartamentit të ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, është vlera totale prej 619.670 lekësh<sup>61</sup>, e cila, mbështetur dhe në praktikën e Kolegjit, përfshin vlerën cash të kursimeve kumulative me burime të ligjshme, para marrjes së detyrës, deri në datën e pagesës së këstit të parë. [...] Nga hetimi, rezultoi se në llogarinë e shtetasit Afrim Shehu, është kryer kreditimi i shumës 85.000 euro, datë 17.10.2016, nga noterja M. LL. person fizik, sipas kontratës nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 8.10.2016. Ndërsa, në datën 18.10.2016, nga kjo llogari është kryer transferta në shumën 20.000 euro, për llogari të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, me përshkrimin: “Pagesë për blerje shtëpie, bazuar në kontratën e porosisë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 8.9.2015”. Gjithashtu, në datën 20.10.2016, është kryer edhe një transfertë tjetër nga llogaria e subjektit të rivlerësimit në shumën 2.840 euro drejt shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, me përshkrimin: “Diferencë për përmbushje në total e detyrimit sipas kontratës së porosisë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 8.9.2015”. Pra, konfirmohet se me vlerën e shitjes së apartamentit të ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, janë kryer pagesat e këstit të tretë dhe të fundit të apartamentit në rrugën “{\*\*\*}”.*

**102.** Komisioneri Publik, në zbatim të rekomandimit të ONM-së, kundërshtoi këtë konkluzion të Komisionit dhe pretendoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të rezultojnë me mungesë të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, duke u ndodhur, për rrjedhojë, në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

**103.** Në mbështetje të këtij shkaku ankimi, ankuesi pretendoi se lidhur me burimet e ligjshme të pasurisë apartament banimi, ndodhur në Tiranë, me adresë rruga “{\*\*\*}”, dhe të shumës së deklaruar të përdorur për mobilimin e kësaj pasurie në vlerën 11.000 euro, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës mbi ligjshmërinë e të ardhurave të huadhënësit, shtetasit E. Q., dhe pretendimet e tij se shuma e dhënë hua nga ky shtetas ka si burim të ardhurat e shtetasit G. Zh.. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës mbi burimet e ligjshme:

<sup>60</sup> Në poshtëshënimin nr. 78 në vendimin e Komisionit, ky i fundit referon: “Nga analiza financiare për pagesat e kësteve, Komisionit i rezultoi se subjekti kishte pamundësi për shlyerjen e tyre me të ardhura të ligjshme në vlerën totale 39.005 euro ose 5.276.206 lekë”.

<sup>61</sup> Sipas poshtëshënimin nr. 72 në vendimin e Komisionit: “Vlera e kursimit cash para detyre prej 379.670 lekësh + vlera e shtesës në vitin 2011 prej 240.000 lekësh + shtesa me burim të ligjshëm e vitit 2014 prej 223.309 lekësh”.

(i) të pagesave të kryera në vitin 2015; (ii) të huadhënësit E. Q. për pagesën e këstit të dytë në vitin 2016, në vlerën 40.000 euro, referuar kërkesave të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016; si dhe (iii) për shpenzimet e mobilimit të kësaj pasurie në vlerën 11.000 euro, nisur nga pamjaftueshmëria e konstatuar për krijimin e kursimeve në *cash* në vijim.

104. Lidhur me burimin e deklaruar të ardhura nga shitja e pasurisë apartament, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Komisioneri Publik pretendoi se, për sa kohë nuk u provuan burimet e ligjshme në blerje të kësaj pasurie, rrjedhimisht edhe të ardhurat nga shitja e saj, deklaruar si burimi kryesor i blerjes së apartamentit të banimit në rrugën “{\*\*\*}”, nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 61<sup>62</sup>, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës.
105. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij para trupit gjykues gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, mbajti të njëjtin qëndrim me atë të parashtruar gjatë hetimit administrativ në Komision. Subjekti i rivlerësimit prapësoi si të pabazuara pretendimet e ankuesit lidhur me vlerësimin e kësaj pasurie.
106. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit pretendoi se huaja e marrë nga E. Q. sipas aktit noterial nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 27.09.2016, është kaluar nëpërmjet bankës dhe është kthyer menjëherë po nëpërmjet bankës, pas shitjes së apartamentit. Gjatë hetimit administrativ, sipas subjektit, është provuar dhe pranuar nga Komisioni ligjshmëria e burimeve të krijimit të kësaj vlere, e cila ka si burim të ardhurat e shtetasit G. Zh. nga puna në Angli.
107. Sipas subjektit, edhe pse Komisioneri Publik ka ngritur dyshime mbi burimin e të ardhurave të E. Q., nga provat e depozituara dhe verifikimet e kryera, është vërtetuar se këto fonde që dispononte E. Q., kishin origjinë të ardhurat e ligjshme të shtetasit G. Zh. (bashkëshorti i vajzës së N. dhe motrës së E.), i cili jetonte në një ekonomi të përbashkët familjare me familjen e N. në Londër. Për këtë arsye, kursimet e tyre kishin dëshirë t’i investonin në Shqipëri prandaj ato i ka ruajtur E. (i cili ishte kthyer në Shqipëri në vitin 2007), fillimisht në *cash* dhe më pas në llogari bankare. Shumat janë transferuar/sjellë ndër vite për periudhën 2005-2009 dhe, pas vitit 2009, G. ia ka transferuar E. lekët në llogari bankare. Nga verifikimi i lëvizjeve në llogarinë bankare të shtetasit E. Q., rezulton se në vitet 2011-2013 është transferuar shuma prej rreth 28.905 paund, fakt ky që mbështet deklarinimin se G. i ka sjellë kursimet e tij në Shqipëri dhe ato janë mbajtur nga E.. Sipas subjektit të rivlerësimit, provohen edhe hyrje-daljet e shtetasit G. Zh. territori i Republikës së Shqipërisë dhe mundësia e tij për të sjellë *cash* fondet e depozituara nga shtetasi E. Q. në llogaritë bankare.
108. Subjekti pretendoi se në kontratën e datës 13.01.2010, kur është hapur llogaria për depozitimim e vlerës 70.000 euro, pasqyrohet se adresa e banimit të E. Q., është rruga “{\*\*\*}”, pall. {\*\*\*}, Tiranë, adresë kjo e cila përkon me adresën e banimit të vëllait të subjektit A. Sh.. Ky fakt, sipas tij, vërteton se të ardhurat e sjella nga Anglia janë lënë në ruajte pranë vëllait A. Sh., aty ku dhe

---

<sup>62</sup> Kjo referencë e përdorur në ankim konstatohet të jetë lapsus, qëllimi kuptohet të ketë qenë referimi në nenin D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës.

banonte E.. Një e dhënë tjetër në mbështetje të faktit se këto vlera të dërguara nga G. Zh. dhe familjarë të tjerë janë lënë në ruajtje te zyra e A. Sh., është dhe prokura e përgjithshme nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 29.09.2009, me të cilën E. Q. ka emëruar përfaqësues të posaçëm vëllain A. Sh., të cilit i ka dhënë të drejtë për të vepruar në llogaritë e tij bankare në lekë, USD, euro dhe GBP pranë çdo banke në Republikën e Shqipërisë. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti i rivlerësimit dorëzoi edhe disa akte<sup>63</sup> të cilat u morën në cilësinë e provës nga trupi gjykues.

109. Në lidhje me kursimet *cash* ndër vite të deklaruara para datës 31.12.2014, subjekti i rivlerësimit pretendoi se, nga analiza e kryer prej tij për periudhën para fillimit të detyrës (viti 2009), ka rezultuar një gjendje negative prej 663.566 lekësh. Kjo gjendje negative duhet t'i zbritet gjendjes së likuiditetit të deklaruar prej tij para fillimit të detyrës dhe analiza e gjendjes *cash* në vazhdim të përlllogaritet sipas deklarimit në deklaratat vjetore periodike, qëndrim ky, sipas subjektit të rivlerësimit, në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit dhe të Komisionit. Subjekti sqaroi se në rast të deklarimit të gjendjes *cash* para fillimit të detyrës, bazuar në analizën e tij financiare, gjendja e likuiditetit në vitet në vazhdim të deklarimit, përlllogaritet aq sa është mundësia e kursimit përpara detyrës. Gjendja negative e krijuar para fillimit të detyrës, për sa i takon gjendjes *cash*, nuk mund të mblidhet me diferencën që mund të rezultojë gjatë viteve të ushtrimit të detyrës.
110. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik për mospërmbysje të barrës së provës lidhur me burimet e ligjshme për mbulimin e shpenzimeve të mobilimit, nisur nga pamjaftueshmëria e konstatuar për krijimin e kursimeve në *cash*, subjekti i rivlerësimit prapësoi se analiza financiare e viteve 2010 dhe 2011 ka rezultuar me balancë pozitive dhe Komisioneri Publik nuk ka pretenduar pamjaftueshmëri financiare për këto vite. Në këto kushte, sipas subjektit, pasaktësia në përcaktimin e shpenzimeve të mobilimit apo e burimit të krijimit të tyre nuk mund të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore.
111. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të çështjes, si dhe shqyrtoi pretendimet e palëve në lidhje me shkaqet e ankimit në kundërshtimin e konkluzioneve të Komisionit lidhur me krijimin e pasurisë objekt kontrolli, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.
112. Sa u takon pretendimeve në lidhje me huadhëniet në vlerat 40.000 euro dhe 5.000 dollarë, të dhëna nga z. E. Q., trupi gjykues vëren se si konstatuar nga Komisioni dhe Komisioneri Publik, referuar kontratës së huasë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 27.09.2016, E. Q. i ka dhënë subjektit të rivlerësimit në formë huaje, një shumë prej 40.000 eurosh dhe 5.000 dollarësh amerikanë,

---

<sup>63</sup> Shkresa nr. {\*\*\*}, datë 04.03.2025, e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, për hyrje-daljet e shtetasve N. Q., B. Q., M. Q., E. Q., G. Xh., M. Sh. dhe A. Sh.; prokura e përgjithshme me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 29.09.2009, me të cilën E. Q. ka emëruar përfaqësues të posaçëm A. Sh.; dhe "kontrata depozitë" e datës 13.01.2010, e njësuar me origjinalin.

përkatësisht në periudhat: në muajin gusht të vitit 2015 shumën prej 5.000 USD, e cila është dhënë *cash*, si dhe 40.000 euro në mars të vitit 2016, nëpërmjet transaksionit bankar.

113. Në këto kushte, bazuar në parashikimet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, në cilësinë e huadhënësit, kanë detyrimin për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për huadhënien objekt kontrolli, për rrjedhojë pretendimi i Komisionerit Publik lidhur me verifikimin e mundësisë financiare të huadhënësit, z. E. Q., vlerësohet i drejtë dhe i bazuar në ligj.
114. Në kuadër të verifikimeve të kryera në Kolegj lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së burimeve të huadhënëve të mësipërme, trupi gjykues konstatoi se nga lëvizjet bankare në Bankën Kombëtare Tregtare, rezultoi se shuma e përdorur për dhënien e huasë subjektit të rivlerësimit, në vlerën e 40.000 eurove, është depozituar *cash* në datën 13.1.2010, nga shtetasi E. Q., në vlerën 70.000 euro, dhe është mbajtur si depozitë kursimi deri në datën 8.3.2016, kur është kryer transfera prej 39.952 eurosh drejt llogarisë së subjektit të rivlerësimit në Raiffeisen Bank, me përshkrimin: “Huadhënie për blerje shtëpie”. Në vijim, në datën 9.3.2016, është kryer transfera e shumës 30.000 euro nga llogaria e subjektit drejt llogarisë së shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, për pagesën e apartamentit. Pjesa e mbetur prej 10.000 eurosh rezulton të jetë tërhequr nga llogaria bankare e subjektit, përkatësisht: në datën 14.06.2016, shuma prej 5000 eurosh; në datën 23.08.2016, shuma prej 2952 eurosh; dhe në datën 08.09.2016, shuma prej 2000 eurosh.
115. Nga verifikimi i kryer në Kolegj lëvizjeve bankare të shtetasit E. Q., u konstatua se për periudhën janar 2007 – maj 2009, ky shtetas kishte përfutur të ardhura nga paga nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, në llogarinë bankare pranë bankave Intesa San Paolo dhe Raiffeissen, në shumën totale prej 1.205.974 lekësh, dhe për periudhën 05.05.2011 - gusht 2015 kishte përfutur të ardhura nga paga si i punësuar pranë të njëjtit punëdhënës, në shumën 3.307.561 lekë në llogarinë bankare pranë Credins Bank.
116. Të ardhurat e realizuara nga shtetasi E. Q. si i punësuar në periudhën kohore 2007—2009, u morën në analizë nga Kolegji në kuadër të verifikimit të mundësisë së këtij shtetasi për të justifikuar burimin e ligjshëm të huasë së dhënë subjektit të rivlerësimit në shumën 9.962 euro në vitin 2009, analizë e cila, si trajtuar më sipër në këtë vendim, rezultoi me pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme në shumën e 4302 eurove. Në këto kushte, trupi gjykues konstatoi se të ardhurat e realizuara nga punësimi për periudhën e viteve 2007-2009, nuk mund të kenë shërbyer për krijimin e shumës prej 70.000 eurosh të depozituar në bankë në datën 13.01.2010, sikundër konstatohet që të mos kenë shërbyer as të ardhurat e krijuara nga punësimi në periudhën 2011-2015, si burime të ardhurash të krijuara pas depozitimit të shumës prej 70.000 eurosh, nga ku është kryer edhe transferimi i fondeve të dhëna hua subjektit të rivlerësimit në shumën e 39.952 eurove në vitin 2016.
117. Të ardhurat e krijuara nga punësimi i shtetasit E. Q. në periudhën 2011-2015, u morën në analizë nga trupi gjykues për verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar

huanë e dhënë subjektit të rivlerësimit në shumën 5.000 USD, në vitin 2015, nga ku huadhënësi rezultoi me mundësi kursimi në shumën 2.519.378 lekë<sup>64</sup>, duke justifikuar ligjshmërinë e huasë së dhënë në shumën e plotë të saj, prej 5.000 USD, në kuptim të parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

118. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur E. Q. nuk arritën të justifikojnë me burime të ligjshme në kuptim të parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, huanë e deklaruar në shumën e 40.000 eurove, të kaluar nëpërmjet sistemit bankar, në shumën e plotë të saj.
119. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se kjo hua kishte si burim të ardhurat e shtetasit G. Zh., nuk u gjet i bazuar në prova, pasi gjatë gjykimit të çështjes nuk u gjet asnjë gjurmë e dokumentuar që do ta bënte të besueshëm për trupin gjykues këtë pretendim. Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe faktin se të vetmet të dhëna të rezultuara nga verifikimi i akteve në fashikull, që provonin kalimin e fondeve nga G. Zh. tek E. Q., u përkisnin 5 transfertave bankare në favor të këtij të fundit, me shumë totale prej 20.905 GBP, të kryera në intervalin kohor 15.11.2012 - 30.09.3.2013, pas krijimit të depozitës prej 70.000 eurosh në datën 13.01.2010. Për më tepër, disponimi i lirshëm nga E. Q. i kësaj vlere likuiditeti nëpërmjet kontratës së huasë<sup>65</sup> në emër dhe për llogari të tij, si dhe veprimet e kryera me këtë likuiditet nga llogaria e tij bankare si titullar i saj, krijuan bindjen e trupit gjykues se ndryshe nga sa pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, këto shuma nuk provohen të jenë kursime ndër vite të G. Zh.. Po ashtu, edhe aktet e depozituara në cilësinë e provës gjatë gjykimit në Kolegj: (i) të dhënat e hyrje-daljeve sipas sistemit TIMS të shtetasve N. Q., B. Q., E. Q., G. Zh., M. Sh. dhe A. Sh.; (ii) prokura e lëshuar nga E. Q. dhe dhënia e tagrave të caktuar lidhur me administrimin e llogarive bankare të këtij të fundit, vëllait të subjektit të rivlerësimit A. Sh., me anë të të cilave subjekti kërkoi të provojë pretendimet e tij lidhur me sjelljen në Shqipëri të kursimeve të familjes së N. Q. (kuntatit të subjektit), përfshirë dhe dhëndrin e tij G. Zh., dhënien e tyre për ruajtje A. Sh. dhe faktin se përkohësisht pjesë e këtyre kursimeve të destinuara për t'iu kaluar A. Sh. në vitin 2005, i janë dhënë bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit për ruajtje, e cila i ka depozituar për një kohë të shkurtër në bankë etj., u çmuan nga trupi gjykues pa vlerë provuese në drejtim të fakteve të pretenduara.
120. Në lidhje me pretendimet e Komisionerit Publik lidhur me të ardhurat e krijuara nga shitja e apartamentit në rrugën “{\*\*\*}”, të cilat kanë shërbyer si burim për shlyerjen e një pjese të çmimit të blerjes së apartamentit objekt kontrolli, trupi gjykues, bazuar në parashikimet e nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi se, për sa kohë krijimi i pasurisë së paluajtshme apartament në rrugën “{\*\*\*}”, si analizuar më sipër, ka rezultuar me

---

<sup>64</sup> Të ardhurave nga pagat në shumën 3.307.561 lekë, pasi u zbriten shpenzimet e jetesës për një person për këtë periudhë, të përlllogaritura sipas standardit të Kolegjit, bazuar në të dhënat e INSTAT-it, në shumën 788.183 lekë, rezulton një mundësi kursimi e përlllogaritur në shumën 2.519.378 lekë.

<sup>65</sup> Shih nenin 1050 të Kodit Civil, “Huaja”.

mungesë të burimeve të ligjshme në shumën e 28.146 eurove për blerjen e tij në shumën e 79.800 eurove, pretendimi i ankuesit për mospërmbushjen e standardit të ligjshmërisë së të ardhurave të krijuara nga shitja e këtij apartamenti, u gjet pjesërisht i bazuar në fakte dhe në ligj. Për rrjedhojë, në kushtet kur pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme në blerjen e apartamentit në rrugën “{\*\*\*}”, rezultoi të jetë e pjesshme, të ardhurat e krijuara nga shitblerja e kësaj pasurie u trajtuan si burim i ligjshëm për krijimin e pasurisë objekt kontrolli, deri në masën e justifikuar me burime të ligjshme në blerje. Në këto kushte, këto të ardhura u morën në analizë në kuadër të vlerësimit të pagesave të kryera për blerjen e apartamentit në rrugën “{\*\*\*}”, në raport me burimet e deklaruara dhe dinamikën e veprimeve të kryera për shlyerjen e çmimit sipas kësteve të përcaktuara në kontratën e lidhur me shoqërinë ndërtuese “{\*\*\*}” ShPK.

121. Në lidhje me burimin *kursime ndër vite*, deklaruar para datës 31.12.2014, pasi shqyrtoi pretendimet e palëve, si dhe analizoi deklaratimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me kursimet *cash* në banesë, duke i vlerësuar ato në raport me të dhënat e administruara gjatë shqyrtimit të çështjes, në konsideratë edhe të konkluzioneve të arritura nga shqyrtimi i shkaqeve të ankimit lidhur me vlerësimin e pasurive të paluajtshme apartament në rrugën “{\*\*\*}” dhe apartament në rrugën “{\*\*\*}”, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
122. Lidhur me kursimet *cash* të deklaruara në shumën prej 15.000 eurosh në deklaratën e parë pas fillimit të detyrës si prokuror në vitin 2009, nisur nga premisa se në deklaratën e parë të dorëzuar në ILDKPKI në vitin 2005, subjekti i rivlerësimit nuk kishte deklaruar kursime gjendje *cash* në banesë, si dhe se, për pagimin e kësteve deri në datën 02.10.2005, për pasurinë apartament në rrugën “{\*\*\*}”, ai rezultoi me mungesë të burimeve të ligjshme, trupi gjykues vlerësoi të analizojë nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, mundësinë e kursimit të subjektit për të justifikuar me burime të ligjshme kursimin e deklaruar gjendje *cash*, në shumën e 15.000 eurove, për periudhën 02.10.2005 - 09.12.2009. Nga analizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera gjatë kësaj periudhe, përfshirë edhe investimet për krijim pasurish, trupi gjykues konstatoi një balancë negative në shumën (-) 6.826.415 lekë, e përafërt me rezultatin e përlllogaritur për të njëjtën mënyrë dhe periudhë nga ONM-ja<sup>66</sup> në rekomandimin për ankim të datës 30.09.2024. Si rrjedhojë e kësaj analize, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të plotë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e kursimeve *cash* në shumën prej 15.000 eurosh.
123. Kursimet *cash* të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat e interesave periodikë në periudhën 2010-2014, rezultojnë në shumën 1.010.000 lekë. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për periudhën 2010-2016, vitet 2010 dhe 2011 rezultuan me balanca pozitive edhe pas kontrollit të ushtruar në Kolegj. Për pasojë, kursimet në gjendje *cash* të deklaruara në vitet 2010 dhe 2011, përkatësisht në shumat 120.000 lekë dhe 240.000 lekë, u vlerësuan me burime të ligjshme. Lidhur me shtesën e kursimeve *cash* në shumën prej 650.000 lekësh, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të viti 2014, trupi gjykues konstatoi se, nga analiza e kryer nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë të burimeve të ligjshme në

---

<sup>66</sup> Shih tabelën në faqet 15-17 të rekomandimit për ankim të ONM-së.

shumën (-) 429.494 lekë, rrjedhimisht vlera e kursimeve *cash* që mund të justifikohet me burime të ligjshme përlllogaritet në shumën 220.506 lekë. Sipas kësaj analize, trupi gjykues konstatoi se kursimet ndër vite në gjendje *cash* deri në datën 31.12.2014, të justifikuara me burime të ligjshme, rezultojnë në shumën 580.506 lekë.

124. Në përfundim të analizës së mësipërme, pas korigjimit në Kolegj të analizës financiare të Komisionit për pasurinë objekt kontrolli të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, me vlerë 12.720.000 lekë dhe të shlyer me këste<sup>67</sup>, sipas konkluzioneve të arritura më sipër nga trupi gjykues, bazuar në pretendimet e ankuesit mbi: (i) burimet e ligjshme të kursimeve *cash* të akumuluar deri në datën 31.12.2014; (ii) burimet e ligjshme të huave të marra nga shtetasi E. Q. në shumat 40.000 euro dhe 5.000 USD; dhe (iii) ligjshmërinë e të ardhurave të realizuara nga shitja e apartamentit në rrugën “{\*\*\*}”, trupi gjykues vëren se:

124.1. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për pagimin e këstit të parë të apartamentit në shumën 40.000 euro në datën 08.09.2015, në shumën e 1.612.294 lekëve<sup>68</sup>.

124.2. Lidhur me pagesën e kryer për këstin e dytë në shumën 30.000 euro, në datën 09.03.2016, dhe shpenzimet e kryera për mobilimin e kësaj pasurie në shumën 10.000 euro, për të cilat subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim huanë e marrë nga shtetasi E. Q., sipas kontratës së huasë në vitin 2016, subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën e plotë të këstit të dytë dhe shpenzimeve të deklaruara për mobilimin në të njëjtin vit të apartamentit në rrugën “{\*\*\*}”.

124.3. Lidhur me pagesën e këstit të tretë prej 20.000 eurosh, në datën 18.10.2016, si dhe të këstit të fundit prej 2.840 eurosh, në datën 20.10.2016, pasi konstatoi se këto pagesa ishin kryer në llogarinë bankare të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK nga llogaria e subjektit të rivlerësimit në Raiffeisen Bank, menjëherë pas kreditimit të kësaj të fundit në datën 17.10.2016, me shumën prej 85.000 eurosh, me burim të ardhurat nga shitja e apartamentit në rrugën “{\*\*\*}”, trupi gjykues arriti në konkluzionin se këto pagesa justifikohen me burime të ligjshme, për sa kohë të ardhurat e vlerësuar me burim të ligjshëm nga ky transaksion shitblerjeje, në shumën e 56.000 eurove, mbulonin tërësisht pagesat e kryera. Për rrjedhojë, pretendimi i ankuesit lidhur me trajtimin e këtij

---

<sup>67</sup> Në datë 08.09.2015 – 40.000 euro; në datë 08.03.2016 – 39.952 euro; në datë 18.10.2016 dhe 20.10.2016 – 22.840 euro, dhe me burime krijimi: (i) llogari kursimi [...] në emër të D. Sh. në Union Bank, krijuar me të ardhurat ndër vite; (ii) hua nga E. Q., akti noterial nr. {\*\*\*} rep/{\*\*\*} kol., datë 27.09.2016 (e shlyer totalisht me të ardhura nga shitja e shtëpisë); (iii) kursime ndër vite të deklaruara para datës 31.12.2014; (iv) shitja e apartamentit me sip. 89,95 m<sup>2</sup> [...], në adresën rruga {\*\*\*} [...] Tiranë, sipas kontratës nr. {\*\*\*} rep/{\*\*\*}kol., datë 20.10.2016, në vlerën 85.000 euro.

<sup>68</sup> Mungesa e burimeve për pagimin e këstit të parë në shumën 40.000 euro: [5.506.000 lekë – 580.506 lekë kursime *cash* të ligjshme – 633.200 lekë huaja nga E. Q. – 2.680.000 lekë likuiditete në llogarinë e kursimit në Union Bank = 1.612.294 lekë].

burimi u çmua nga trupi gjykues pa efekt në analizën e kryer për burimet e ligjshme të krijimit të kësaj pasurie.

125. Në përfundim të analizës për vlerësimin e krijimit të pasurisë apartament në rrugën “{\*\*\*}”, trupi gjykues arriti në konkluzionin se për investimin e kryer, në shumën totale prej 12.720.000 lekësh, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, në shumën e 5.670.394 lekëve<sup>69</sup>.
126. *Lidhur me shkaku e ankimit të Komisionerit Publik mbi pretendimet për disa zëra të analizës financiare, si kursimet në gjendje cash, shpenzimet e evidentuara nga karta e kreditit, si dhe në tërësi lidhur me verifikimin e saktësisë së analizës financiare të Komisionit, të kryer për periudhën e vlerësimit 2003-2016*, trupi gjykues, në konsideratë të konkluzioneve të arritura mbi vlerësimin e pasurive objekt kontrolli sipas këtij ankimi, arriti në përfundimin se këto konkluzione janë të mjaftueshme në drejtim të vlerësimit të besueshmërisë së subjektit të rivlerësimit lidhur me kriterin e pasurisë, në kuptim të nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, analizimi dhe arsyetimi i këtij shkaku ankimi u vlerësua nga trupi gjykues pa peshë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes dhe, rrjedhimisht, i panevojshëm.

*C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale*

127. *Sa i takon kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, për të cilin Komisioneri Publik, në zbatim edhe të rekomandimit të ONM-së të datës 30.09.2024, pretendoi se gjetjet e rezultuara gjatë hetimit administrativ, janë të tilla që bien ndesh me vlerat themelore të pritura nga një magjistrat, siç parashikohet në nenin 3, pika 5 e ligjit nr. 96/2016 dhe udhëzimet ndërkombëtare që rregullojnë sjelljen e magjistratëve, si brenda dhe jashtë sistemit gjyqësor dhe bëjnë që subjekti të gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016*, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
128. Trupi gjykues vëren se Komisioneri Publik shkaku e ankimit në lidhje me kundërshtimin e konkluzionit të Komisionit mbi vlerësimin e këtij kriteri e ka bazuar në pretendimet mbi gjetjet e rezultuara nga shqyrtimi i 3 denoncimeve, për të cilat, sipas tij, subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse duke afektuar respektivisht indikatorët e parashikuar në nenet 75, 74, pika 4 dhe 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016. Më konkretisht:

128.1. *Lidhur me denoncimin e shtetasit S. Sh., të depozituar pranë ONM-së në datën 23.08.2023 dhe për të cilin vëzhguesi ndërkombëtar që monitoronte procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, ka sugjeruar hetimin e këtij denoncimi, Komisioneri Publik, në zbatim edhe të rekomandimit të ONM-së, pretendoi se bazuar në aktet e fashikullit të Komisionit, edhe pse nuk*

---

<sup>69</sup> Mungesë burimesh për këstin e parë në shumën 1.612.294 lekë, në vitin 2015; mungesë burimesh për këstin e dytë prej 4.058.100 lekësh, në vitin 2016; në total mungesë burimesh në shumën 5.670.394 lekë.

mund të provohet nga hetimi administrativ përfshirja e subjektit dhe roli i tij i drejtpërdrejtë në procedimin penal nr. 661/2020 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, mbetën të dokumentuara disa rrethana faktike, si: koha, vendi dhe mënyra e takimit të subjektit të rivlerësimit me shtetasit e përfshirë në procedim, të cilat, më së paku, bien ndesh me sjelljen që duhet të ketë një prokuror, bazuar në standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së prokurorit, miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

**128.2.** *Në lidhje me denoncimin e shtetasit E. M.* të shqyrtuar nga Komisioni, i cili rezultoi të ketë paraqitur një kallëzim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në vitin 2014, mbi bazën e të cilit është regjistruar procedimi penal me nr. {\*\*\*}, datë 24.11.2014, i cili, në kohën e shqyrtimit nga Komisioni të këtij denoncimi, ishte akoma në prokurori për hetimin e disa dokumenteve të pretenduara nga denoncuesi si të falsifikuara dhe mbi bazën e të cilave, sipas tij, i janë përvetësuar në mënyrë të padrejtë pronat në bashkëpronësi të familjes M.. Denoncuesi E. M. ka pretenduar se hetimi është zvarritur me dashje nga subjekti i rivlerësimit. Lidhur me këtë denoncim, Komisioni, pasi i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të dhënë shpjegime mbi sa pretenduar nga denoncuesi për moskryerje të veprimeve hetimore, ka arritur në konkluzionin se subjekti nuk ka argumentuar bindshëm arsyet e mosveprimit të tij lidhur me kryerjen e veprimeve hetimore, por duke e vlerësuar këtë çështje në zbatim të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, në kushtet kur kjo është ende nën hetim, ka arritur në konkluzionin se kjo çështje nuk mund të vlerësohet në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale.

**128.3.** Komisioneri Publik konfirmoi qëndrimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës, duke mos dhënë shpjegime bindëse lidhur me moskryerjen e veprimeve hetimore dhe zvarritjen e procesit, por, ndryshe nga ai, pretendoi se procedimi penal nr. {\*\*\*}/2014 përmban rrethana që mund të vlerësohen për efekt të procesit të rivlerësimit të z. Afrim Shehu, pasi, sipas tij, në kuptim të dispozitave procedurale, asnjë vlerësim që organet e rivlerësimit bëjnë në këtë rast, nuk afekton vendimmarrjen për këtë çështje, për më tepër që vlerësimi në çdo rast u referohet treguesve të kriterit të aftësive profesionale, pa marrë përsipër të gjykohet mbi korrektësinë e vendimmarrjes.

**128.4.** *Në lidhje me denoncimin e shtetasit O. V.*, e cila pretendoi se nga subjekti i rivlerësimit janë kryer shkelje flagrante, duke vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2018, Komisioni ka konstatuar në përfundim të hetimit të këtij denoncimi<sup>70</sup>, se kërkesat e vazhdueshme të subjektit të rivlerësimit Afrim Shehu, për pushimin e çështjes nr. {\*\*\*}/2018, janë refuzuar 3 herë nga gjykatat e dy shkallëve për moskryerje hetimesh të plota dhe për mospërmbyllje detyrash të lëna nga gjykata, në kundërshtim me nenin 329/b të Kodit të Procedurës Penale. Komisioni, pasi i ka kaluar barrën e provës lidhur me gjetjen e mësipërme, në vlerësim të prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, ka arritur në konkluzionin se: *subjekti i rivlerësimit ka mbështetur, bazuar në*

---

<sup>70</sup> Shih konstatimet e Komisionit lidhur me situatën faktike në lidhje me dinamikën e hetimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe vlerësimin e gjykatave të të dy niveleve në paragrafin 457 të vendimit të Komisionit objekt ankimi, si dhe në mënyrë më të detajuar në parashtrimin e Komisionit në rezultatet e hetimit administrativ, në faqet 85-89.

*argumente ligjore dhe në bindjen e tij të brendshme, vendimet e tij, të cilat janë parashtruar edhe në ankimet që ai ka depozituar ndaj vendimeve të gjykatës. Gjithashtu, nga ana procedurale, subjekti ka përmbushur detyrat e lëna nga gjykatat, duke kryer hetime të mëtejshme, ashtu siç specifikohet në vendimet gjyqësore, në përputhje me shkronjën “b” të pikës 3 të nenit 329 të Kodit të Procedurës Penale dhe në mënyrë vijuese ka marrë përsëri vendim pushimi të çështjes. Sa më sipër, shpjegimet e subjektit janë bindëse dhe, për pasojë, nuk përmbajnë elemente që lidhen me procesin e rivlerësimit të subjektit.*

**128.5.** Komisioneri Publik, lidhur me sa më sipër, pretendoi se ka elemente që duhen vlerësuar nga Kolegji për efekt të procesit të rivlerësimit, elemente të cilat, sipas tij, lidhen me sjelljen e prokurorit kundrejt detyrimeve që burojnë nga vendimet e gjykatës në rolin e organit kontrollues të veprimtarisë hetimore. Në mbështetje të këtij shkakui ankimi, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, nuk ka kryer veprime hetimore të logjikshme dhe të hollësishme, në shmangie të zbatimit të detyrimeve që vijnë nga vendimet gjyqësore, për të përmbyllur hetimin në mënyrë të plotë, duke afektuar indikatorin e parashikuar nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

- 129.** Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në parashtrimet e tij para Kolegjit në seancën publike të datës 02.04.2025, lidhur me tri çështjet penale objekt i vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale: (i) denoncimin e shtetasit S. Sh.; (ii) denoncimin e shtetasit E. M.; dhe (iii) denoncimin e shtetases O. V., deklaroi se të metat e evidentuara në secilën prej këtyre çështjeve penale janë të tilla që nuk mund të shërbejnë si bazë për kërkimin e zbatimit të dispozitës së nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe kualifikimin si cenim të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, për sa vijon.

**129.1.** *Lidhur me denoncimin e shtetasit S. Sh.,* Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme parashtrroi se në analizë të këtij rasti, vlerësohet se nga aktet në dosjen e Komisionit, rezultojnë të provuara rrethana që konfirmojnë përfundimin e arritur nga Komisioni. Premisa në dukje se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur një qasje të papërshtatshme në takimin me babanë e një personi të dyshuar për veprën penale të “Trafikimit të lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, në një procedim penal të trajtuar nga kolegu i tij në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, në juridiksionin e së cilës subjekti i rivlerësimit ushtronte detyrën, ndikimi negativ në perceptimin për favorizim të mundshëm nga njerëzit e drejtësisë ndaj autorëve të veprave penale, si dhe që bien ndesh me sjelljen që duhet të ketë një prokuror, bazuar në standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së prokurorit, miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbetet në nivelin e premisë që nuk passjell situatën e ndonjë prej shkeljeve sipas dispozitave të ligjit nr. 96/2016, që zbatohen për vlerësimin e aftësisë profesionale të prokurorit dhe që do të shërbente për vlerësimin tërësor në kuptim të nenit 4, pika 2 dhe nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

- 130.** *Lidhur me denoncimin e shtetasit E. M.,* Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme vlerësoi, sikurse Komisioni, se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës dhe nuk dha shpjegime bindëse, lidhur me moskryerjen e veprimeve hetimore dhe zvarritjen e procesit. Subjekti i rivlerësimit, si funksionari përgjegjës për të kryer në mënyrë të efektshme procedurat hetimore,

nuk ka dhënë shpjegime bindëse mbi moskryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale, brenda afatit kohor të përcaktuar, duke afektuar indikatorët e parashikuar nga neni 74, “Aftësisë organizative”, pika 4 e ligjit nr. 96/2016. Kjo mangësi e evidentuar merret në konsideratë së bashku me mangësi të tjera në çështjet penale të hetuara nga subjekti i rivlerësimit, për të arritur në vlerësimin nëse shkeljet ligjore të evidentuara janë të asaj shkalle që të cenojnë besimin e publikut të drejtësia dhe, si rrjedhim, të passjellin aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

131. *Lidhur me denoncimin e shtetases O. V.*, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka vlerësuar të drejtë përfundimin e arritur nga Komisioni se: *subjekti i rivlerësimit ka mbështetur vendimet e tij në argumente ligjore dhe në bindjen e tij të brendshme. Gjithashtu, nga ana procedurale, subjekti ka përmbushur detyrat e lëna nga gjykatat, duke kryer hetime të mëtejshme ashtu siç specifikohet në vendimet gjyqësore, në përputhje me shkronjën “b” të pikës 3 të nenit 329 të Kodit të Procedurës Penale dhe në mënyrë vijuese ka marrë përsëri vendim pushimi të çështjes. Sa më sipër, shpjegimet e subjektit janë bindëse dhe, për pasojë, nuk përmbajnë elemente që lidhen me procesin e rivlerësimit të subjektit.*
132. Për rrjedhojë të sa më sipër, në mbështetje të nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, nenit 44 të ligjit nr. 49/2012 dhe nenit 463 të Kodit të Procedurës Civile, Drejtuesi Prokurorisë së Posaçme hoqi dorë nga shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.
133. Ndodhur në këto kushte, trupi gjykues, në konsideratë edhe të parashikimeve të nenit 463 të Kodit të Procedurës Civile, vlerësoi se konkluzionet e Komisionit lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, mbeten të pacenuara.
134. Në përfundim të gjykimit, në vijim të konkluzioneve të mësipërme në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë, bazuar në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ndodhen në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm të kriterit të vlerësimit të pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, çmohet se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë, në kuptim të nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, nuk është i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, si i tillë, duhet të ndryshohet.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

**VENDOSI:**

1. Ndryshimin e vendimit nr. 762, datë 15.05.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Afrim Shehu.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 08.05.2025, në Tiranë.

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënskrimi*

**ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënskrimi*

**ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënskrimi*

**RELATOR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Albana SHTYLLA**

*nënskrimi*